

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

P. Nr. 128/10

16 Shtator 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, me Trupin Gjykses të përbërë nga Gjykatësi i EULEX-it Gianfranco Gallo në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykses, Gjykatëses së EULEX-it Verginia Micheva-Ruseva si dhe të Gjykatësit vendor Gezim Pozhegu në cilësinë e anëtarëve të Trupit Gjykses, të ndihmuar nga procesmbajtësja Robina Struthers, në lëndën penale kundër të akuzuarve:

1. **Muhamet Demaj**, i biri i Abdullah dhe Cymes, me mbiemrin e vajzërisë Pajaziti, i lindur më 10/04/1977 në fshatin Jabllanica e Madhe, Komuna e Pejës, me vendbanim aktual në Istog Istog, në Rrugën "Skënderbeu" pn, ka të kryer shkollën e mesme, student, i martuar dhe babë i dy fëmijëve, me gjendje ekonomike mesatare, shqiptar/kosovar, momentalisht në paraburgim për shkak të rastit aktual;
2. **Bajram Mehmetaj**, i biri i Ukës dhe Mirës, me mbiemrin e vajzërisë Rexhepaj, i lindur më 09/11/1972 në Fshatin Zabllaq, Komuna e Pejës, duke banuar në të njëjtin vend, ka të kryer shkollën e mesme, student, i martuar, me gjendje ekonomike mesatare, shqiptar/kosovar, momentalisht në paraburgim për shkak të rastit aktual;
3. **Azem Veseli**, i biri i Rexhepit dhe Shkurtës, me mbiemrin e vajzërisë Elshani, i lindur më 08/03/1964 në Fshatin Llabjan, Komuna e Pejës, banor i të njëjtit vend, ka të kryer shkollën e mesme, i angazhuar në FSK, i martuar dhe babë i pesë (5) fëmijëve, me gjendje ekonomike mesatare, shqiptar/kosovar, nuk zhvillohen hetimet penale kundër tij dhe aktualisht në paraburgim për shkak të rastit aktual;

akuzohen, sipas Aktakuzës PP. nr. 84/10 të datës 29 mars 2010, me veprat penale si në vijim:

Detyrim në kundërshtim me nenin 267 par 2, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), të kryer që nga 21 nëntori 2009 e deri më 28 shkurt 2010 në Pejë.

Pas mbajtjes së gjykimeve kryesore publike më 4, 5, 12, 24 dhe 25 gusht; 15 dhe 16 shtator 2010 në praninë e:

- Prokurorit Publik dhe të Prokurorit të EULEX-it,
- të akuzuarit Muhamet Demaj dhe Avokatit tij Mbrojtës Z. Zeqir Bujupaj,
- të akuzuarit Bajram Mehmetaj dhe Avokatit tij Mbrojtës Z. Zeqir Berdynaj,
- të akuzuarit Azem Veseli dhe Avokatit tij Mbrojtës Z. Gezim Kollçaku;
- palës së dëmtuar dhe të Përfaqësuesit të palës së dëmtuar Z. Ferid Gjickolli;

Pas këshillimit dhe votimit të Trupit Gjykses të mbajtur më 16 shtator 2010, në bazë të Nenit 391 Paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK),

më 16 shtator 2010, në pajtim me Nenin 392 Paragrafi (1) të KPPK-së, në vijim shpall publikisht dhe në prezencën e palëve të lartpërmendura këtë:

A K T G J Y K I M

Muhamet Demaj, Bajram Mehmetaj dhe Azem Veseli

shpallën

FAJTORË

Për Detyrim në bashkëkryerje në kundërshtim me Nenet 23 dhe 267 par. 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sepse ata në Pejë, në periudhën kohore në mes të nëntorit dhe të dhjetorit 2009, të duke vepruar në cilësinë e anëtarëve një grupi, me qëllim të sigurimit të një përfitimi të paligjshëm dhe të madh material, e kërcënuan Ekrem Llukën me fjalët “mos mendo se ne dimë vetëm të thyejmë dritare” dhe “pot ë paralajmëroj” për të detyruar që atyre të ua jap 150.000 Euro, gjysmën e së cilës aktualisht ia kishte dhënë, nëpërmes ndërmjetësit Naim Hajrizit, Muhamet Demajt në dhjetor të vitit 2009.

Dhe të

Detyrim në Tentativë në bashkëkryerje në kundërshtim me Nenet 20, 23 dhe 267 par 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sepse ata në Pejë, më 28 shkurt 2010, të duke vepruar në cilësinë e anëtarëve një grupi, ndërmorën një aksion të drejtpërdrejtë për të detyruar Ekrem Llukën që të ua jap 75.000 Euro, duke e kërcënuar ndërmjetësin Naim Hajrizin duke thënë se nuk iu epet pjesa tjetër prej 75.000 Eurove Peja do të kallet nëse nuk i marrin të hollat për shkak të refuzimit të Ekrem Llukës që të paguajë shumën e lartpërmendur.

Në këtë mënyrë, u cilësua veprimi kriminal i ndërmarrë nga të pandehurit

PRANDAJ, Muhamet Demaj, Bajram Mehmetaj dhe Azem Veseli,

DËNOHEN

Secili nga dy vjet (2) me burg, për veprën penale të Detyrimit në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenet 23 dhe 267 par 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK);

Si dhe nga një (1) vit burg për secilin, për veprën penale të Detyrimit në Tentativë në bashkëkryerje në kundërshtim me nenet 20, 23 dhe 267 par 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK),

Dënimi unik, në pajtim me Nenin 71 Paragrafi (1) dhe (2) Nënparagrafi 2 të Kodit të Procedurës penale të Kosovës është përcaktuar me burg prej dy (2) vjetëve dhe gjashtë (6) muajve për secilin të pandehur.

Koha e kaluar në paraburgim nga ana e të pandehurve që nga 01.03.2010 e deri më 28.05.2010 si dhe nga 16.06.2010 e më tutje, do të zbritet nga dënimi në pajtim me nenin 391 Paragrafi (1), Nënparagrafi 5 dhe Neni 278 par 7 të Kodit të Procedurës penale të Kosovës.

Të akuzuarit do t'i kompensojnë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) të KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve për interpretim dhe përkthim. Nga Gjykata do të lëshohet një Aktvendim i posaçëm lidhur me shumën e shpenzimeve atëherë kur të sigurohen të dhënat përkatëse në pajtim me nenin 100 Paragrafi (2) të KPPK-së.

ARSYETIMI

A. SFONDI PROCEDURAL – AKTAKUZA

Më 29 mars 2010, Prokurori Publik i Qarkut ka paraqitur Aktakuzën PP.no.84/2010 kundër Muhamet Demajt, Bajram Mehmetajt dhe Azem Veselit, duke i akuzuar ata për veprën penale të *Detyrims* në pajtim me Nenin 267 par 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

Sipas Prokurorit Publik, gjatë periudhës 21 nëntor 2009 – 28 shkurt 2010 të pandehurit, duke vepruar në cilësinë e anëtarëve të një grupi, kanë ushtruar presion dhe kërcënime kundër palës së dëmtuar Ekrem Llukës dhe e kanë detyruar atë që të ua jap një shumë prej 150.000 Euro për ta lënë që të merret lirshëm me blerjen e Hotelit/Ilixhes "ONIX" në Banjën e Pejës.

Aktakuza është konfirmuar më 29 prill 2010 me aktvendimin KAQ.nr.102/10.

B. JURIDIKSIONI I GJYKATES

1. Juridiksioni dhe Përbërja e Trupit Gjykues në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

Në pajtim me Nenin 23, paragrafi 1 të KPPK-së, Gjykata e Qarkut do të kenë juridiksionin për gjykuar, në shkallen e pare, veprat penale të dënueshme me burg prej më së paku pesë (5) vjetëve apo me burim afatgjatë.

Në rastin e tashëm të akuzuarit janë akuzuar për *Detyrim*, në kundërshtim me nenin 267, paragrafi 2 të KPK-së, që është e dënueshme me burg prej një (1) e deri më dhjet (10) vjet. Prandaj, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka juridiksionin për të gjykuar këtë rast.

Veprat penale, sipas Aktakuzës, janë kryer në qytetin e Pejës. Prandaj, në pajtim me Nenin 27 par 1 të KPPK-së, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka juridiksionin territorial për të gjykuar këtë rast.

Në pajtim me Nenin 3.3 të Ligjit mbi Juridiksionin, Zgjedhjen e dhe Ndarjen e Rasteve të Gjykatësve dhe të Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, në bazë të kërkesës nga cila do qoftë pale në procedure, Presidentja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mundet me vendos se EULEX-i e merr përsipër atëherë kur konsiderohet se është e nevojshme për administrimin e duhur të drejtësisë si dhe kur vepra penale është e paraparë në Nenin 3 të Ligjit mbi Juridiksion.

Prokurori Publik i EULEX-it në Pejë, ka parashtruar kërkesën pranë Presidentes së Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it më 22 qershor 2010 duke kërkuar që të caktohen gjykatësit e EULEX-it në këtë rast, për shkak të faktit se janë bërë tentime nga ana e të pandehurve që të ushtrojnë ndikim në rrjedhën e procesit gjyqësor.

Pas mbajtjes së seancës dëgjimore në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 7 korrik 2010 ku u dëgjuan të gjitha palët, Presidentja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it lëshoi vendimin që t'i ndahet rasti P.nr.128/10 Gjykatësve të EULEX-it në Pejë.

Trupi Gjykues për këtë rast ishte i përbërë nga një trup gjykues i përbërë nga dy Gjykatës të EULEX-it dhe të një Gjykatësi Vendor. Asnjëra palë nuk e kundërshtoi përbërjen e trupit Gjykues.

2. Seanca Kryesore

Gjykimi kryesor publik u mbajt në lokalet e Gjykatës së Qarkut në Pejë më 04, 05, 12, 24 dhe 25 gusht, 15 dhe 16 shtator 2010 në praninë e Prokurorit Publik, Prokurorit të EULEX-it, të pandehurve, Avokate e tyre Mbrojtës si dhe të përfaqësuesit të palëve të dëmtuara.

Në pajtim me nenin 15 të KPPK-së, përkthyesit ndërkombëtar i seancat Gjyqësore si dhe të gjitha dokumentet relevante për gjykim nga anglishtja në gjuhën Shqipe dhe anasjelltas, sipas nevojës.

C. PËRMBLEDHJA E PROVAVE TË PREZANTUARA

1. Gjatë seancave të gjykimit kryesor, janë ekzaminuar dëshmitarët e poshtëshënuar:

- a) Pala e dëmtuar/dëshmitari *Ekrem LLUKA* u dëgjua më 05 gusht 2010 dhe 15 shtator 2010;
- b) Dëshmitari *Naim HAJRIZI* u dëgjua më 05 gusht 2010;
- c) Dëshmitarja *Klara BOKSHI* u dëgjua më 12 gusht 2010;
- d) Dëshmitari *Armend SUSURI* u dëgjua më 12 gusht 2010;
- e) Dëshmitari *Fatos ZAJMI* u dëgjua më 24 gusht 2010;

- f) Dëshmitarja *Nora KELMENDI* u dëgjua më 24 gushte 2010;
- g) Dëshmitari *Agim ELSHANI* u dëgjua më 15 shtator 2010.

2. Raportet e policisë dhe provat tjera dokumentare të lexuara gjatë seancave Gjyqësore.

a) Provat dokumentare dhe raportet.

Gjatë gjykimit kryesor, dokumentet e poshtëshënuara janë lexuar në cilësi të provës, në pajtim me Nenin 367 të KPPK-së:

- Raporti i Policisë së datës 21.11.2009, numri i rastit 2009-DA-3199, i përpiluar nga Oficerët Sami Hoxha #6154 dhe Enver Salihaj #2788;
- Raporti i Policisë së datës 22.12.2009, numri i rastit 2009-DA-3199, i përpiluar nga Oficeri Ragip Bytyqi #2900;
- Raporti i Policisë së datës 22.02.2010, numri i rastit 2010-DA-436 i përpiluar nga Oficerët Arsim Zabeli #5190 dhe Tomor Hysenaj #4202;
- Kallëzimi Penal kundër Muhamet Demajt, Azem Veselit dhe Bajram Mehmetajt të datës 02.03.2010, numri i rastit 2010-DA-0436;
- Shkresa Zyrtare – Njoftimi Zyrtar i Njësitit Regjional të Hetimeve, të datës 05.03.2010, numri i referencës HE/PE-06/2010;
- Kërkesa e Agjencisë së Privatizimit të Kosovës për Informata të Përgjithshme Hetimore për rastin e Detyrims dhe Kërcënimit kundër palës së dëmtuar Z. Ekrem Llukës më 08.03.2010;
- Dokumente lidhur me procedurën e privatizimit të Hotelit “ONIX” në banjën e Pejës, të paraqitura para Trupit Gjykues nga dëshmitarja Klara Bokshi më 12.08.2010;
- Dokumente dhe një CD që përmbajnë procesin e privatizimit të Hotelit “ONIX” në Banjën e Pejës, e siguruar nga policia nga Agjencia e Privatizimit të Kosovës në bazë të urdhrit të lëshuar nga ana e Trupit Gjykues më 16.06.2010;
- Raporti i Policisë lidhur me Listën e Telefonatave dhe të SMS-ve të bërë, numri i rastit 2010-DA-436 të datës 06 shtator 2010, i përpiluar nga Ragip Bytyqi #2900;
- Raporti i Policisë lidhur me Listën e Telefonatave dhe të përmbajtjes së MSM-ve për numrat: 044 125 003 të Azem Veselit, 044 940 046 të Bajram Mehmetajt, 044 787 876 të Muhamet Demajt, 044 501 994 dhe 049 501 994 të Naim Hajrizit, 049 500 948 të Ekrem Llukës dhe 044 501 733 të Agim Elshanit, për periudhën nga 01 nëntori 2009 e deri më 01 mars 2010;
- Raporti i Policisë mbi Zbulimet Financiare, numri i rastit 2010-DA-436 të datës 08 shtator 2010, i përpiluar nga Ragip Bytyqi #2900;
- Zbulimet Financiare të xhirollogarive bankare të Fatos Zajmit, Dukagjini Shpk, Ekrem Llukës dhe Naim Hajrizit.
- Marrëveshja për Partneritet në mes të Agim Elshanit dhe Muhamet Demajt të datës 20.10.2009.

b) Deklaratat e të pandehurve të dhëna para Trupit Gjykues.

Të pandehurit i dhanë deklaratat e tyre më 25 gusht 2010 dhe më 15 shtator 2010.

D. REKONSTRUIMI I FAKTEVE TË NGJARJEVE

Procedura e Tenderit në APK.

Para se të hyjmë në thelbin e rastit, është mire që të shpjegohen rregullat të cilat janë në fuqi për procedurën e privatizimit për Ndërmarrjet Shtetërore dhe si ishte zhvilluar procedura lidhur me privatizimin e Hotelit ONYX.

Sipas rregullave të Agjencisë së Privatizimit të Kosovës, Agjencia do të përgatis Planin e Tenderit i cili i tregon obligimet dhe afatet që duhet të respektohen nga të gjithë ofruesit në rastet e procedurave të privatizimit.

Sa i përket tenderit për Hotelin “ONIX” në Banjën e Pejës, Agjencia i kishte përcaktuar kushtet e parakualifikimit siç vijon:

Çdo ofrues potencial duhet t'ia sigurojë Agjencisë provat dokumentare të cilat i përmbushin kriteret si në vijim:

(a) Se ajo apo ndonjë Kompani Simotër është kompani profesionale në fushën e Qendrave Klimaterike, e cila është marrë me veprimtari në fushën e Qendrave Klimaterike në çdo vit the pesë (5) viteve të fundit,

dhe / apo

(b) Se ajo e ka një ekip të aftë dhe profesionale të menaxherëve dhe të stafit mjekësor në numër të mjaftueshëm të cilat janë me përvojë në fushën e veprimit të Qendrave Klimaterike dhe të aktiviteteve të kohës së lirë.

Tri kompani paraqiten ofertat e tyre për Hotel:

- “Dukagjini SHPK dhe Thermana” të cilat ofruan shumën e ofertës prej 8.600.000 €;
- “Eldrink” e cila ofroi shumën prej 7.777.000 €;
- “Megi Bau GMBh & Kohl and partner Tourism Consultancy International” e cila ofroi shumën prej 5.010.909 €.

Për të marrë pjesë në tender ofertuesit është dashur të deponojnë shumën prej 500.000 € si dhe të paguajnë taksën administrative prej 2.000 €.

Më 11 nëntor 2009 “Dukagjini SHPK dhe Thermana”, e përfaqësuar nga Fatos Zajmi u shpallën si fitues të përkohshëm.

Sipas rregullave të APK-së, pas shpalljes së fituesit të përkohshëm, ai/ajo njoftohet për kisten e pare të pagesës të çmimit të ofruar e cila është 25% nga shuma e ofruar minus shuma e deponuar.

Më 17 nëntor 2009 Agjencia fituesit të përkohshëm ia ka dërguar një njoftim që të paguajë 25% në një shumë prej 1.665.313 € Brenda 20 ditëve (dmth. deri më 15.12.2009).

Të hollat janë paguar nga ana e “Kompania Dukagjini” në katër shuma të ndryshme:
Më 10/12/2009 janë paguar 100.000 € nëpërmes ProCredit Bank (PCB)
Më 10/12/2009 janë paguar 765.313 € nëpërmes Raiffeisen Bank (RBKO)
Më 21/12/2009 janë paguar 274.000 € nëpërmes Raiffeisen Bank (RBKO)
Më 21/12/2009 janë paguar 526.000 € nëpërmes Nova Ljubljanska Banka (NLB)

Më 02 shkurt 2010, Agjencia e njoftoi Fatos Zajmin se më 15 shkurt 2010 ishte afati i fundit për të paguar pjesën tjetër të mbetur të pagesës prej 75% nga shuma e ofruar (6.495.937 €).

Më 15 shkurt 2010, është dorëzuar një parashtrësë tek APK-ja me të cilën shprehej dëshira e Ekrem Llukës për t'u tërhequr nga blerja dhe për të kërkuar refundimin e të hollave të cilat tashmë ishin paguar lidhur me tenderin (25% të shumës së përgjithshme).

Më 01 mars 2010, Agjencia ia refuzoi kërkesën dhe ia dha një afat përfundimtar deri më 15 mars 2010 për të paguar shumën tjetër të mbetur prej 75% të çmimit të përgjithshëm prej (6.495.938 €).

Më 02 mars 2010, një kërkesë për të rikonsideruar vendimin ishte dërguar nga ana e “Dukagjini Shpk dhe Thermana” nëpërmes përfaqësuesit të saj Fatos Zajmit. Në kërkesë ishte thënë se pronari i Kompanisë Dukagjini Ekrem Lluca kishte marrë kërcënime dhe prej tij kishin kërkuar që Muhamet Demajt dhe grupit të tij t'ia paguante shumën prej 75.000 €.

Më 08 mars 2010, Agjencia ia dërgoi një kërkesë Kryeprokurorit Publik të Qarkut të Pejës të ofronte informata të përgjithshme lidhur me hetimet që kishin të bënin me Kërcënimet e bëra kundër palës së dëmtuar Ekrem Llukës.

Më 16 mars 2010, Agjencia ishte njoftuar nga Zyra e Prokurorisë së Qarkut në Pejë se tre persona ishin në paraburgim lidhur me veprën penale të përmendur këtu më lartë.

Pasi që, ofertuesi i dytë më i lartë ishte në një fare lidhjeje me personat e paraburgosur lidhur me kërcënimet kundër pronarit të Kompanisë Dukagjini, më 01 qershor 2010, Agjencia ia dërgoi një letër ofertuesi të tretë më të lartë “Megi Bau GMBh & Kohl and partner Tourism Consultancy International” të përfaqësuar nga Fahri Deshishku, duke e njoftuar se ai kishte drejtë që të blinte Hotelin “Onix” në Banjën e Pejës sipas çmimit më të lartë që ishte ofruar (dmth. Çmimi që ishte ofruar nga ofertuesi i parë).

Më 08 qershor 2010, pasi që ofertuesi i tretë kishte dështuar që ta paguante shumën e paraparë Brenda afatit të caktuar, është bërë anulimi i procedurës për privatizimin e Hotelit “Onix” në Banjën e Pejës në të njëjtën ditë dhe të hollat e paguara u janë kthyer ofertuesve.

Deklaratat e dëshmitarëve para Trupit Gjyqes

Ekrem LLUKA

Pala e dëmtuar/dëshmitari *Ekrem LLUKA*, në deklaratën e tij para Trupit Gjykses, shpjegoi se ai ishte pronar dhe drejtor i përgjithshëm i Kompanisë Dukagjini. Rreth fundit të vitit 2009 ai kishte marrë pjesë në tenderin e shpallur nga Agjencia e Privatizimit të Kosovës lidhur me Hotelin “Onix” në Banjën e Pejës. Oferta e bërë nga “Dukagjini Company dhe Thermana” ishte më e larta (8.600.000 €) dhe këto dy kompani u patën shpallë si fitues të përkohshëm të tenderit.

Më 21 nëntor 2009, pasi që ishte shpallur fitues i përkohshëm, Lluka u takua me Muhamet Demajn dhe diskutoi me te lidhur me mundësinë që Muhamet Demaj dhe personat tjerë që t’i 15% të aksioneve të Hotelit. Në fund të bisedave, pasi që Lluka nuk dëshironte që të kishte partnerë tjerë, Demaj i tha: *“Mos mendo që ne dimë vetëm të thyejmë dritaret”*¹.

Dëshmitari deklaroi se ai nuk iu ishte përgjigjur Demajt fare, edhe pse në deklaratën e dhënë policisë përgjigjja e tij ishte: *“A po thoni se do të vrisni? Sot, edhe një fëmijë mund të vras dikë, por për këtë ekziston ligji”*.

I konfrontuar nga Trupi Gjykses dëshmitari nuk e mohoj që t’i ketë thënë këto fjalë, por ai deklaroi se nuk ishte absolutisht i sigurt lidhur me këtë, pasi që biseda me Demajn nuk kishte zgjatur më shumë se 2 apo 3 minuta².

Lluka e njoftoi policinë në të njëjtën ditë lidhur me fjalët që i kishte thënë Demaj dhe pas nja katër apo pesë ditëve, Lluka bisedoi me shokun dhe partnerin e tij afarist Naim Hajrizin lidhur me bisedën e lartpërmendur.

Sipas palës së dëmtuar, Naim Hajrizi e kishte njoftuar atë diku në mars se ky i fundit ia kishte dhënë shumën prej 75.000 € për të qetësuar situatën, pasi që grupi i Demajt kërkonte 15% të aksioneve. Lluka deklaroi se ai kishte qenë në botën e jashtme kur Naimi i kishte dhënë të hollat, dhe se ai nuk kishte kërkuar nga Naimi që të bënte këtë pagesë dhe se kjo kishte qenë një iniciativë spontane e këtij të fundit³.

Lluka dëshmoi lidhur me një takim tjetër me Demajn më 28 shkurt 2010 në zyrën e Llukës në Kompaninë Dukagjini; Naim Hajrizi ishte i pranishëm në atë takim gjithashtu dhe Demaj kërkoi nga Lluka që të paguante edhe një shumë prej 75.000 €, por Lluka refuzoi të paguante pasi që ai kishte ndërmend të tërhiqej nga tenderi. Para se të largohej nga zyra Muhamet Demaj iu kthye Naim Hajrizit dhe i tha se nëse Lluka nuk i paguan të hollat atëherë këtë gjë duhet të bënte Naim Hajrizi.

Lluka dëshmoi se më 28 shkurt 2010, pas takimit, ishte njoftuar nga ana e Hajrizit se ky i fundit e kishte pasur edhe një takim me Muhamet Demajn, Bajram Mehmetajn dhe Azem Veselin ku ishte përsëritë kërkesa për të bërë pagesën e mbetur prej 75.000 € dhe nëse ata nuk i marrin këto të holla, atëherë “Peja do të kallet”.

¹ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 05.08.2010 faqja 6.

² Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 05.08.2010 faqja 7.

³ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 05.08.2010 faqja 15.

Dëshmitari ia raportoi këtë policisë, pasi që e ndiente vetën të kërcënuar, edhe pse jo fizikisht⁴.

Lluka shtoi se ai kërcënohej vazhdimisht nëpërmes telefonatave anonime⁵ dhe kështu, ai kishte vendosur që të tërhiqej nga tenderi edhe para se të takohej me Muhamet Demajn.

Naim HAJRIZI

Dëshmitari *Naim HAJRIZI* në deklaratën e tij para Trupit Gjykses shpjegoi se ai punonte në cilësinë e afaristit. Lidhur me procedurën e tenderit për Hotelin “Onix” në Banjën e Pejës, ishte në dijeni se fituesi i përkohshëm ishte Kompania Dukagjini.

Dëshmitari deklaroi se ishte i njohur me tre të pandehurit. Sa i përket tenderit lidhur me Hotelin “Onix” në Banjën e Pejës, ai kishte pasur ca biseda me ta, pas shpalljes së fituesit të përkohshëm dhe se bisedat kishin qenë lidhur me aksionet e Hotelit.

Diskutime ishin bërë zakonisht me Muhamet Demajn dhe Bajram Mehmetajn, por edhe në nja dy apo tri raste edhe Azem Veseli kishte qenë i pranishëm⁶. Të pandehurit kishin kërkuar 10% të aksioneve, por në fund kërkesa nuk ishte pranuar sepse Ekrem Lluka nuk kishte nevojë për aksionarë.

Kur u pyet dëshmitari lidhur me reagimin e të pandehurit pasi që kërkesa e tyre ishte refuzuar, ai u përgjigj se nuk kishte asnjë; deri në këtë moment, dëshmitari u konfrontua me përmbajtjen e deklaratës dhënë para policisë më 01.02.2001:⁷

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqë ju nuk jeni në gjendje që të bëni këtë atëherë unë do t'ju konfrontoj me atë që keni deklaruar para policisë më 01 mars 2010. Ju keni thënë “Kam qenë i involvuar që nga fillimi në bisedat të cilat udhëhiqeshin nga Ekrem Lluka dhe një grup i njerëzve të përbërë nga Muhamet Demaj, Bajram Mehmetaj dhe Azem Veseli. Fillimisht këta njerëz kërkonin 10% të vlerës së përgjithshme të objektit. Por, pas shumë negociatave, intimidimeve dhe shantazheve të bëra dhe të drejtuara në drejtim të Ekrem Llukës, ne arritëm që t'ju ofrojmë këtyre njerëzve një shumë prej 150.000 Eurove e cila shumë u pranua nga ana e tyre”. Pra, tani keni kuptuar se cili ishte qëllimi i deklaratave të dhëna gjatë hetimeve, kjo është thjesht për të parë se a po gënjen dëshmitari apo jo, e jo që ta mohojmë kënaqësinë e paraqitjes këtu. Tani që e lexova me zë të lartë atë që e keni thënë para policisë, a po ju përkujton kjo diç apo jo?

Naim Hajrizi: the same statement I gave to the police is the one that I just gave here now.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo është ajo që keni thënë saktësisht. A është ky nënshkrimi i juaj?

Kryetari i Trupit Gjykses ia tregon dëshmitarit një kopje të deklaratës së tij të dhënë para policisë.

Naim Hajrizi: Po, e imja është.

Pavarësisht nga konfrontimi, dëshmitari deklaroi se të pandehurit ishin pajtuar që të tërhiqen nga kërkesa e tyre të 10% të aksioneve kurse ai atyre iu ofroi që të punësoheshin në Hotel por ata e refuzuan këtë propozim.

⁴ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 05.08.2010 faqja 18.

⁵ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 05.08.2010 faqja 19.

⁶ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 05.08.2010 faqet 33 – 34.

⁷ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 05.08.2010 faqet 35 – 37.

Prandaj, Hajrizi në mënyrë spontane vendosi që t'ju ofrojë atyre 150.000 €, por, fillimisht atyre ua dha shumën prej 75.000 €.

Sa i përket të hollave të cilat iu ishin premtuar të pandehurve, dëshmitari u konfrontua si në vijim:

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte marrëveshja për 75,000 apo ishte ajo për 150,000?

Naim Hajrizi: 150,000.

Kryetari i Trupit Gjykses: A mund të më shpjegoni mua pse është dashur që t'iu epni 150.000 Euro ashtu gratis sepse ata nuk kanë pasur asnjë drejtë në këto të holla. Kjo po tingëllon me të vërtetë çuditshëm.

Naim Hajrizi: Duke filluar nga jeta dhe puna aty ku ne jetojmë, për shembull, ju i merrni 10% të aksioneve, ju ia mundësoni dikujt që të merr 10% dhe pas një viti ai mund të vijë dhe të thotë se nuk i do ato, po ua shes aksionet e mia. Ai ndoshta vjen me një çmim që ndoshta është dyfishi i çmimit fillestar....

Kryetari i Trupit Gjykses: Po rata nuk kanë pasur asnjë drejtë që të kenë çfarëdo qoftë, pra ju ua keni dhënë 75.000 Euro për asgjë. A ka ndodhur kështu?

Naim Hajrizi: Që të mos marrin asnjë aksion.

Kryetari i Trupit Gjykses: A i keni paguar në emër të Ekrem Llukës pasi që ai ka qenë fituesi i tenderit apo i keni paguar spontanisht?

Naim Hajrizi: Së pari, sepse ai ka qenë fitues i tenderit dhe së dyti ishte një kënaqësi për mua që ai ishte fitues i tenderit dhe së treti sepse isha i vetëdijshëm për investimin që dë të ndodhte në të ardhmen, nga kënd vështrimi im e kam konsideruar këtë çështje që të rregullohej në këtë mënyrë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra, kjo paska qenë ide e juaja?

Naim Hajrizi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo është në tërësi ndryshe nga ajo që keni deklaruar para policisë.

Në deklaratën e dhënë para policisë më 01 mars 2010, ju keni thënë se pjesën e parë të shumës prej 75.000 Eurove personalisht ia keni dhënë Muhamet Demajt të cilin e keni paguar në emër të Ekrem Llukës, i cili në atë kohë ishte në Slloveni. Pra, aty keni thënë se pagesën e keni bërë në emër të Ekrem Llukës kurse tani po thoni se pagesën e keni bërë në mënyrë spontane. Cili është versioni i drejtë?

Naim Hajrizi: Unë mund të them se e tërë shumën është paguar nga ana ime në mënyrë private dhe pas arritjes së një marrëveshjeje, pas së cilës do ta informoja Ekrem Llukën i cili nuk ka qenë në dijeni lidhur me këtë marrëveshje⁸.

Sipas dëshmitarit, të hollat janë paguar në të gatshme, përafërsisht në nëntor apo dhjetor 2009, Muhamet Demajt në praninë e Bajram Mehmetajt dhe Azem Veselit⁹. Dëshmitari deklaroi se ai i kishte të hollat në dispozicion dhe nuk i kishte tërheq nga banka. Sa i përket pjesës së mbetur prej 75.000 €, këto të holla do të epeshin pas përfundimit të procedurës së privatizimit.

Pastaj dëshmitari deklaroi se kishte qenë një takim në zyrën e Ekrem Llukës në Kompaninë Dukagjini me Muhamet Demajn në fund të shkurtit, në të cilin Ekrem Llukës kishte thënë se ai kishte ndërmend që të tërhiqet nga tenderi dhe se Muhamet Demaj do të duhej të kthente shumën prej 75.000 € të cilën tashmë e kishte marrë.

⁸ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 05.08.2010 faqet 37 – 38.

⁹ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 05.08.2010 faqja 38:

Kryetari i Trupit Gjykses: Kujt ia keni dhënë të hollat?

Naim Hajrizi: Metit. Galani ishte prezent dhe po ashtu edhe Azem Veseli ishte aty.

Pas takimit që e kishte pasur me Muhamet Demajn dhe Ekrem Llukën, dëshmitari po në të njëjtën ditë u takua përsëri me Metin (Muhamet Demajn), Galanin (Bajram Mehmetajn) dhe Azem Veselin në një kafe/barin “Calabria”. Ata biseduan lidhur me tërheqjen e Ekrem Llukës nga tenderi dhe pastaj ata e kërkuan pjesën tjetër të mbetur prej të hollave (75.000 €) duke thënë se nëse nuk paguhen të hollat “të mërkurën, Peja do të kallet”. Dëshmitarit nuk i kujtohej saktësisht se kush i kishte thënë këto fjalë të lartpërmendura, por ato janë thënë deri sa të gjithë ishin ulur në kafe/barin në fjalë.

Klara BOKSHI

Dëshmitarja *Klara BOKSHI* deklaroi se ajo punonte në APK në cilësinë e oficerës për transaksione. Detyra e saj kryesore ishte që të bënte verifikimin e pagesave të bëra nga ana e ofertuesve, që të përgatiste dokumentacionin e duhur për ofertuesit të cilët e kishin humbur tenderin, për të bërë refundimin e depozitave të tyre, që të njoftojnë fituesit lidhur me fitoret e tyre të përkohshme dhe që të verifikojë pagesat e kryera¹⁰.

Dëshmitarja shpjegoi se kur caktohet fituesi në cilësinë e fituesit të përkohshëm i cili nuk e paguan shumën e plotë për shkak të kërcënimeve, rasti gjithmonë dërgohet në Zyrën Ligjore të Agjencisë për të bërë vlerësimin dhe vendimi përfundimtar merret nga ana e Këshillit Punëdrejtues¹¹.

Sa i përket tenderit të Hotelit “Onix” në Banjën e Pejës, ajo e kishte njoftuar fituesin dhe e kishte verifikuar depozitën. Fituesit e përkohshëm ishin “Dukagjini SHPK dhe Thermana” të përfaqësuar nga Fatos Zajmi. Në realitet Dukagjini dhe Thermana ishin dy kompani të ndryshme, të cilat kishin bërë një ofertë të përbashkët për Hotelin¹².

Ajo e kishte verifikuar pagesën dhe i kishte njoftuar të dy kompanitë që të bëhej pjesa tjetër e mbetur e pagesës prej 75% (dmth. 6.495.937 Euro). Pas kërkesës së Llukës për t’u tërheq nga tenderi, vendimi përfundimtar ishte refundimi i të hollave të paguara nga ato dy kompani.

Më konkretisht, sipas dëshmitares depozita prej 500.000 € ishte paguar më 11/11/2009. Njoftimi për të bërë pagesën e 25% (dmth. 1.665.313 Euro) ishte dërguar më 17/11/2009 dhe afati i fundit për të bërë pagesën ishte më 15/12/2009.

Pastaj, Fatos Zajmi ka deponuar tri letra në APK; një njoftim lidhur me kërcënimet më 23.11.2009, një kërkesë për tërheqje nga tenderi më 02.03.2010 dhe edhe një kërkesë tjetër për tërheqje më 15.03.2010.

Pjesa prej 25% iu kthye Kompanisë Dukagjini më 05.03.2010, mirëpo lidhur me depozitën dëshmitarja nuk e dinte se kur ishte kthye kjo.

Armend SUSURI

¹⁰ Procesverbal i Gjykimit Kryesor të datës 12.08.2010 faqja 3.

¹¹ Procesverbal i Gjykimit Kryesor të datës 12.08.2010 faqja 4.

¹² Procesverbal i Gjykimit Kryesor të datës 12.08.2010 faqja 5.

Dëshmitari *Armend SUSURI* në dëshminë e tij para Trupit Gjykses deklaroi se ai ishte Udhëheqës i Marketingut në APK. Sfera e punës së tij përbëhej kryesisht nga promovimet, mirëpo ai po ashtu kishte kontakte me ofertuesit.

Sa i përket tenderit për Hotelin “Onix” në Banjë të Pejës, ai nuk ka qenë i involvuar dhe nuk ka ditë se kush ishin investitorët. Pas përfundimit të shitjes dhe shpalljes së fituesit të përkohshëm, atëherë Nora Kelmendi, Drejtoresha e Departamentit të Shitjeve, ishte involvuar në procedurë.

Sa i përket tërheqjes së depozitit, dëshmitari deklaroi se vendimet ishin marrë nga ana e Këshillit të Drejtorëve, i cili ishte i përbërë nga tre ekspertëve ndërkombëtar dhe pesë vendor. Dëshmitari shpjegoi se, sipas praktikës, një nga arsyet për të kthyer depozitën ishte edhe rasti i kërcënimeve kundër ofertuesit.

Fatos ZAJMI

Dëshmitari *Fatos ZAJMI* në deklaratën e tij të dhënë para Trupit Gjykses deklaroi se është i inkuadruar në Kompaninë Dukagjini në cilësinë e avokatit që nga 5 gushti 2002. Ai e përfaqëson kompaninë lidhur me çështjet juridike.

Lidhur me pjesëmarrjen në tenderët e privatizimit, ai e ka autorizimin e përgjithshëm për të bërë ofertë kurse sa i përket çështjeve civile Gjyqsore, a ka nevojë për një autorizim specifik nga pronari i kompanisë. Z. Ekrem Lluka.¹³

Lidhur me procedurën e privatizimit të Hotelit “Onix” në Banjën e Pejës, ai e përgatiti dhe e dorëzoi dokumentacionin pranë AKP-së në Prishtinë lidhur me tenderin. Transferimi i depozitës në një shumë prej 500.000 € ishte bërë nga Departamenti i Financave të Kompanisë.

Sipas dëshmitarit nuk kishte pasur asnjë problem deri në shpalljen e fituesit të përkohshëm. Në nëntor të vitit 2009, ai ishte ftuar nga Ekrem Lluka i cili e kishte informuar atë se ishte kërcënuar nga ca njerëz. Ekrem Lluka e kishte lutur dëshmitarin që të njoftonte Agjencinë lidhur me këto kërcënime.¹⁴

Dëshmitari konfirmoi se ai Agjencisë i kishte shkruar dhe nënshkruar tri letra në emër të punëdhënësit të tij Z. Ekrem Llukës si dhe në bazë të udhëzimeve të tija.

Letra e pare ishte dorëzuar më 23 nëntor 2009 dhe në të ishte thënë se pronari i Kompanisë Dukagjini, Z. Ekrem Lluka, kishte pasur një takim me ca njerëz të cilët e kishin kërcënuar atë lidhur me blerjen e Hotelit “Onix” në Banjën e Pejës dhe se Ekrem Lluka e kishte njoftuar Policinë Regjionale të Pejës lidhur me ato kërcënime.¹⁵

Dëshmitari deklaroi se Ekrem Lluka e kishte thirr dhe i kishte treguar se ai kishte pasur një takim me disa njerëz dhe se ata e kishin kërcënuar lidhur me blerjen e Hotelit. Ekrem Lluka nuk kishte përmend se kush ishin ata njerëz. Sipas dëshmitarit Z. Lluka donte vetëm që ta informonte Agjencinë lidhur me rrethanat.

Letra e dytë ishte dërguar më 15 shkurt 2010 dhe ishin përmend kërcënime tjera nga njerëz të ndryshëm. Sipas dëshmitarit, ai e kishte përshtypjen se Ekrem Lluka ishte i

¹³ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 24.08.2010 faqet 2 – 5.

¹⁴ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 24.08.2010 faqet 5 – 6.

¹⁵ Letra gjendet në Dosjen e Vëllimit të II të Gjykimit Kryesor, shtojca III – Dokumentet e APK-së.

frikësuar dhe për shkak të këtyre kërcënimeve kishte vendosur që të tërhiqej. Dëshmitari e kishte pranuar një thirrje nga Ekrem Lluka i cili i kishte treguar se ai dëshironte që të tërhiqej nga tenderi për shkak të këtyre kërcënimeve dhe se Fatos do të duhej të dërgonte një letër Agjencisë duke e njoftuar lidhur me qëllimin e Kompanisë për tërhiqje. Para se të dorëzonte njoftimin, dëshmitari e kishte thirr Ekrem Llukën dhe ia kishte lexuar disa pjesë relevante të letrës dhe Ekrem Lluka ishte pajtuar më përmbajtjen e saj. Dëshmitari e mori një telefonatë nga Ekrem Lluka i cili i tregoi se dëshironte që të tërhiqej nga tenderi për shkak të këtyre kërcënimeve dhe se Fatosi do të duhej t'ia dërgonte një letër Agjencionit për të njoftuar lidhur me qëllimin e kompanisë për tërheqje. Para se ta dorëzonte njoftimin dëshmitari e thirri Ekrem Llukën dhe ia lexoi disa pjesë të rëndësishme të letrës me përmbajtjen e të cilave u pajtua Ekrem Lluka.¹⁶

Njoftimi i tretë u dorëzua më 03 mars 2010 në formë të përgjigjes ndaj vendimit të Këshillit të AKP-së që e kishte refuzua kërkesën e Ekrem Llukës për tërhiqje. Në atë letër, e shkruar nga Fatos Zajmi në bazë të udhëzimeve të marra nga Ekrem Lluka, nga Këshilli i Drejtorëve kërkohej që të rishqyronte vendimin e vet sepse Ekrem Lluka përsëri ishte kërcënuar nga Muhamet Demaj dhe grupi i tij për të marrë shumën prej 75.000 €. ¹⁷

Letra, me të cilën kërkohej leja për tërhiqje nga tenderi ishte shkruar nga Fatosi në bazë të udhëzimeve të marra nga Ekrem Lluka dhe Fatosi ia lexoi disa pjesë të asaj letre Ekrem Llukës para se të bënte dorëzimin e saj.¹⁸

Veç kësaj, dëshmitari shpjegoi se të dy kompanitë, Dukagjini Shpk dhe Thermana (një kompani Sllovene), kishin vendosur që të ofronin një ofertë të përbashkët për Hotelin "Onix". Dëshmitari po ashtu e kishte autorizimin nga Drejtori i Thermanës për t'i përfaqësuar në këtë procedurë të tenderit. Sipas kontratës në mes të dy kompanive, aksionet e Hotelit do të ishin 90% Dukagjini dhe 10% Thermana.¹⁹

Nora KELMENDI

Dëshmitarja *Nora KELMENDI*, Drejtoresha e Departamentit të Shitjes në AKP, deklaroi se lidhur me procedurën e tenderit për privatizimin e Hotelit "Onix", Agjencia kishte pranuar vetëm tre ofertues.²⁰ Sipas dëshmitares nuk kishte pasur asnjë problem lidhur me procedurën e privatizimit deri në momentin kur Agjencia e pranoi një kërkesë nga Ekrem Lluka i cili shprehte dëshirën që të tërhiqej nga blerja sepse kishte qenë i kërcënuar.

Sa i përket letrave të dorëzuara nga Fatos Zajmi në emër të Ekrem Llukës, ajo shpjegoi se me rastin e dorëzimit të letrës së dytë ishte vendosur që të ajo të dërgohej së bashku me një shkresë të menaxhmentit Këshillit të Drejtorëve. Shkresa ishte përpiluar nga Shkëlzen

¹⁶ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 24.08.2010 faqet 8 – 9.

¹⁷ Letra gjendet në Dosjen e Vëllimit të II të Gjykimit Kryesor, shtojca III – Dokumentet e APK-së. Data në atë letër shënon "02.02.20100", por është e qartë se ishte ky një gabim dhe kjo është qartësuar gjatë seancës së datës 24.08.2010 faqja 8, dhe se kjo është dashur të ishte 02.03.2010.

¹⁸ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 24.08.2010 faqja 10.

¹⁹ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 24.08.2010 faqet 11 – 14.

²⁰ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 24.08.2010 faqja 16.

Lluka i cili po ashtu ishte i pranishëm në takimin e Këshillit. Më 25 shkurt 2010 Këshilli vendosi që të refuzohej kërkesa për tërhiqje.

Kur Agjencia e mori letrën e tretë nga Fatos Zajmi dhe para se ta dërgonte atë në Këshill, Departamenti ku punonte dëshmitarja iu ishte drejtuar Prokurorisë Publike të Qarkut në Pejë për informata.

Më 12 mars 2010, Agjencia ishte njoftuar se tre persona ishin arrestuar për Detyrim lidhur me këtë rast. Më 15 mars 2010 mbaroi afati i fundit për të bërë pagesën e plotë të ofertës, por Ekrem Lluka këtë nuk e kishte bërë.

Dëshmitarja e shkroi një shkresë më 28 maj 2010 për të informuar Këshillin. Në shkresë ajo kishte shkruar tri opsione: ose të anulohet tenderi dhe të ktheheshin të hollat tek fituesi i përkohshëm ose të vazhdohej me tender dhe të pyetej ofertuesi i dytë që të paguante shumën ose të pyetej ofertuesi i tretë më i lartë që të paguante shumën e tërësishme.²¹

Dëshmitarja shpjegoi se në bazë të rregullave dhe të përvojës së AKP—së, nëse fituesi i përkohshëm Agjencisë ia paraqet raportet e policisë duke provuar se ai/ajo ishte kërcënuar, paratë tashmë të paguara zakonisht ktheheshin.

Përfundimisht, Këshilli vendosi që të mos e anulonte tenderin dhe të ftonte ofertuesin e tretë (ofertuesi më i lartë i dytë ishte diskualifikuar, sepse siç doli në shesh ai kishte disa marrëveshje të fshehta me personat që gjendeshin në paraburgim për Detyrim) që të paguante çmimin e ofruar nga fituesi i përkohshëm. Mirëpo, ofertuesi i tretë nuk pagoi, meqë dallimi në mes të ofertës së tij dhe asaj të bërë nga Ekrem Lluka ishte shumë e lartë (diku rreth 3.300.000 €).

Prandaj, AKP-ja e anuloi tenderin në bazë të rregullave në fuqi.²²

Agim ELSHANI

Dëshmitari *Agim ELSHANI* në deklaratën e tij të dhënë para Trupit Gjykes deklaroi se ai kishte marrë pjesë në tenderin për privatizimin e Hotelit “Onix” në Banjën e Pejës dhe se ishte ofertuesi i dytë më i lartë. Për të marrë pjesë në këtë tender ai kishte nevojë që të kishte një “ekip profesional të përbërë prej menaxherëve dhe të stafit mjekësor” dhe, ai e kishte kërkuar ndihmën e Muhamet Demajt që t’i kontaktonte këta njerëz.

Ai e kishte bërë një kontratë me shkrim me Muhamet Demajn me të cilin Muhamet Demaj ishte përgjegjës për gjetjen e këtyre njerëzve dhe t’i kontaktonte ata; nëse do ta fitonte tenderin, Muhamet Demaj do të kishte 15% të aksioneve.²³

Kur u pyet se a kishte edhe një marrëveshje me Ekrem Llukën, dëshmitari tha se ai ishte konsultuar me te që të bëheshin partnerë, mirëpo ata nuk e arritën ndonjë marrëveshje.

I konfrontuar me deklaratën e dhënë para policisë më 16.12.2009 në të cilën ai i referohej një marrëveshjeje me Ekrem Llukën (“*dua të shtoj se një ditë para tenderit kam biseduar*

²¹ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 24.08.2010 faqja 20.

²² Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 24.08.2010 faqet 21 – 22.

²³ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 15.09.2010 faqet 10 – 11.

me Ekrem Llukën, kemi pasur një takim zyrtar lidhur me tenderin, dhe kemi arritë një kontratë verbale ku u pajtuam se nëse Ekrem Lluka fiton dhe unë jam i dyti, ne do të ulemi dhe do të bisedojmë për hapat e mëtejshëm) Elshani konfirmoi se kishte biseda me Ekrem Llukën, por ata nuk bënë ndonjë marrëveshje me shkrim. Ata u pajtuan se pas procedurës së tenderit, ata do të bisedonin lidhur me hapat eventual që do të ndërmerreshin në fund të procedurës së tenderit²⁴.

Sipas dëshmitarit, në ditën e shpalljes së fituesit, përafërsisht pas pesë orëve, ai e thirri Ekrem Llukën me telefon dhe e ftoi që të pinin kafë bashkë dhe për të biseduar lidhur me mundësitë lidhur me tenderin, mirëpo përgjigjja e Ekrem Llukës ishte se ai ishte fituesi dhe se nuk kishte asgjë për të biseduar.

Pasi që kishte folur me Ekrem Llukën, Elshani i telefonoi Muhamet Demajt dhe i tregoi se e kishte humbur tenderin. Sipas dëshmitarit, Muhamet Demaj ishte pak I dëshpëruar, pasi që kjo ishte normal në raste të tilla.²⁵

Lidhur me raportin e tij me Muhamet Demajn, dëshmitari deklaroi se e njihte Muhamet Demajn që nga lufta në Kosovë pasi që kishin shërbyer bashkë në të njëjtën brigade (Muhameti dhe Bajrami ishin ushtarë, ai ishte Zëvendës Komandant dhe Azem Veseli ishte Komandant i Brigadës). Pas luftës Elshani e kishte punësuar Muhamet Demajn në fabrikën e birrës të cilën e udhëhiqte.

Elshani kishte dëgjuar se Muhamet Demaj po ashtu kishte një marrëveshje me Ekrem Llukën lidhur me tenderin e Hotelit "Onix", por nuk e dinte përmbajtjen e marrëveshjes dhe ai nuk ka folur me ta asnjëherë lidhur me atë.²⁶

Sa i përket marrëveshjes me shkrim në mes tij dhe Muhamet Demajt, dëshmitari shpjegoi se marrëveshja ishte vetëm një marrëveshje e partneritetit dhe se nuk kishte asnjë reference ndaj shumës se të hollave të involvuara. Sikur ata të kishin fituar tenderin, atëherë ata do të diskutonin lidhur me hollësitë.²⁷

Dëgjimi i dytë i Ekrem Llukës.

Pala e dëmtuar/dëshmitari *Ekrem LLUKA* është dëgjuar për here të dytë më 15 shtator 2010 lidhur me tri letrat e dorëzuara tek Agjencia Kosovare e Privatizimit në emër të tij.

Sa i përket letrës së parë, dëshmitari shpjegoi se ai e kishte lutur avokatin e tij që ta njoftonte Agjencinë se ai kishte marrë disa kërcënime dhe se e kishte njoftuar Fatosin lidhur me përmbajtjen e letrës, edhe pse nuk ishte ndier i kërcënuar.²⁸

²⁴ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 15.09.2010 faqet 11 – 12.

²⁵ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 15.09.2010 faqja 13.

²⁶ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 15.09.2010 faqja 16.

²⁷ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 15.09.2010 faqja 17.

²⁸ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 15.09.2010 faqet 2 – 3.

Sa i përket letrës së dytë, dëshmitari deklaroi se ajo ishte shkruar nga Fatosi në bazë të udhëzimeve të tija (duke përfshirë aty edhe fjalën “kërcënim” e cila disa herë ishte përmend në letër).

Sa i përket letrës së tretë, dëshmitari potencoi se ai e kishte lutur avokatin e tij që ta shkruante, por mohoi që të ketë udhëzuar atë për të përdorë fjalët siç janë “Kërcënime, Shantazh, Mashtrues” të cilat aktualisht ishin përdorë.

Sa i përket ndonjë marrëveshjeje të mundshme me Agim Elshanin lidhur me tenderin për Hotelin “Onix” në Banjën e Pejës, dëshmitari deklaroi se ata kishin folur me njëri tjetrin para tenderit, por ata nuk kanë pasur ndonjë marrëveshje. Ekrem Lluka i tregoi Elshanit se ai do të bënte një ofertë bashkë me një partner nga Sllovenia, prandaj nuk ka qenë i interesuar që të kishte edhe një partner tjetër.

Deklarata e të Pandehurit para trupit Gjykses

Muhamet DEMAJ

Muhamet DEMAJ në deklaratën e tij para Trupit Gjykses konfirmoi se e kishte njohur palën e dëmtuar Ekrem Llukën që dhjetë vite dhe se ata gjithmonë kishin qenë në raporte të mira. Sa i përket tenderit të Hotelit “Onix” në Banjën e Pejës, ai dinte se Ekrem Lluka dhe të tjerët kishin marrë pjesë në tender.

I pandehuri deklaroi se ai dëshironte që të kishte një pjesë të aksioneve të hotelit, duke i blerë ato nëpërmes të fituesit të tenderit.

Pasi që Ekrem Lluka e kishte fituar tenderin, Naim Hajrizi i tregoi të pandehurit se do të mund të ishte e mundur për të pandehurin Muhamet Demajn me i marrë 10% të aksioneve. Pasi që i pandehuri nuk ishte në gjendje për një blerje të tillë, ai e kishte lutur shokun e tij Bajram Mehmetajt që të merrte pjesë në aksione. Pas disa ditëve Hajrizi iu kishte treguar atyre se nuk kishin mundur të blejnë ndonjë aksion, pasi që Ekrem Lluka atëherë veç e kishte një partner, një kompani nga Sllovenia²⁹.

Pastaj Naim Hajrizi i tregoi të pandehurit se ndoshta i pandehuri vet do të mund të bisedonte me Ekrem Llukën dhe në muajin nëntor të vitit 2009 Muhamet Demaj u takua me Ekrem Llukën.

Gjatë takimit ky i fundit tha se nuk mund të shiste asnjë aksion.

Muhamet Demaj mohoi para këtij Trupi Gjykses se refuzimit të sipërm i kishte thënë fjalët: “*Mos mendo se ne dimë vetëm të thyejmë dritare*”.

Pas kësaj bisede, i pandehuri u takua me Naim Hajrizin dhe ai u ofroi Muhamet Demajt dhe Bajram Mehmetajt 150.000 €, pasi që marrëveshja nuk mund të finalizohet.

I pandehuri e pranoi ofertën vetëm pasi që Naim Hajrizi kishte insistuar. Pra, Naim Hajrizi i dha të pandehurit 75.000 € në praninë e Bajram Mehmetajt. Azem Veseli nuk ishte i pranishëm kur Naim Hajrizi i kishte dhënë të hollat, por Azem Veseli kishte qenë i pranishëm më herët në kafene para se të vinte Naim Hajrizi. Të hollat e pranuar ishin nda në mes të Muhamet Demajt dhe Bajram Mehmetajt.

Sipas të pandehurit të hollat ishin dhënë diku rreth fundit të nëntorit apo në fillim të dhjetorit, dy apo tri javë pas takimit që e kishte pasur me Ekrem Llukën.

²⁹ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 25.08.2010 faqja 5.

Marrëveshja ishte se pjesa tjetër e parave atyre do t'iu epej pas finalizimit të procedurës së tenderit³⁰.

I pandehuri as nuk u takua e as nuk e thirri me telefon Ekrem Llukën deri më 28 shkurt 2010. Disa ditë më herët i pandehuri ishte informuar nga Naimi se Ekrem Lluka ishte në prag të tërheqjes nga tenderi. Prandaj, u organizua një takim plotësues në mes të Naimit, Muhamet Demajt dhe Ekrem Llukës në lokalet e Kompanisë Dukagjini. I pandehuri i tregoi Ekrem Llukës se Naimi i kishte premtuar 150.000 €, por ai kishte marrë vetëm gjysmën e kësaj shume të hollave dhe tha se gjysma tjetër do të paguhej nga vet Ekrem Lluka. Por, Ekrem Lluka të pandehurit iu përgjigj duke i thënë ishte duke u tërhequr nga tenderi, se ai nuk do t'ia epte të hollat fare dhe se nëse marrëveshja ishte bërë me Naimin atëherë ky i fundit do të duhej t'ia paguante ato të holla. Atëherë kishte përfunduar takimi.

Më vonë, në të njëjtën ditë, ai u takua me Naimin edhe një herë; Bajram Mehmetaj po ashtu ishte i pranishëm por jo edhe Azem Veseli. Naimi kërkoi që t'i ktheheshin të hollat brenda një muaji.

Muhamet Demaj nuk ishte përgjigjur dhe nuk i tha fjalët siç janë: "Ne do ta kallim Pejën". I pandehuri u konfrontua lidhur me këtë si në vijim:

Prokurori Publik: Ju po ashtu jeni dëgjuar edhe nga Prokurori Publik, dhe sipas procesverbalit të kësaj interviste ju keni thënë lidhur me takimin që keni pasur me Naimin ju keni thënë se në atë takim je e keni kërcënuar Naimin, numri i faqës në versionin anglez është 4, paragrafi 5 më 19 mars. Pra ju keni thënë në atë takim me naimin "ne e kemi kërcënuar Naimin por në emër të dikujt tjetër". A ju kujtohet që të keni thënë këtë?

Muhamet Demaj: Jo. Nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik: Ju keni thënë se ju e keni kërcënuar Naimin në emër të dikujt tjetër dhe se nuk është e vërtetë që ia kemi caktuar një afat deri të mërkurën për të paguar të hollat dhe se Peja do të kallej. Ne e kemi përmendur këtë lidhur me këtë rast, ne do ta dërgojmë atë në Gjykatën e Pejës.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo është thënë nga një person që nuk donte të holla?

Muhamet Demaj: Unë nuk e kam thënë atë, ndoshta Prokurori Publik e ka thënë atë.³¹

Lidhur me mesazhet SMS nëpërmes numrit të telefonit 044-787 876, i pandehuri pranoi se numri sipër përmendur ishte i tij.

I pyetur lidhur me mesazhin SMS ("Urime, Urime") që i ishte dërguar në numrin e Bajram Mehmetajt më 11 nëntor 2009 (dita në të cilën Ekrem Lluka ishte shpallur fitues i tenderit), i pandehuri tha se nuk dinte asgjë lidhur me atë mesazh dhe sidoqoftë ai nuk kishte asgjë të bënte me tenderin. Ai më në fund shtoi se në ato ditë ishin zgjedhjet dhe ndoshta mesazhi ka qenë në lidhje me rezultatet e zgjedhjeve. Kur iu përkujtua se zgjedhjet ishin mbajtur më 15 nëntor 2009, ai tha se ndoshta mesazhi ka qenë në lidhje me festat e 28 nëntorit (edhe pse u konfrontua me faktin se mesazhi ishte dërguar gati 20 ditë para festave)³².

Lidhur me një mesazh SMS tjetër ("E morëm", i dërguar Azem Veselit më 11 nëntor 2009, vetëm dy minuta pas atij mesazhi që ia kishte dërguar Bajram Mehmetajt, i pandehuri tha se ai i referohej zgjedhjeve komunale.

³⁰ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 25.08.2010 faqet 8 – 10.

³¹ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 25.08.2010 faqet 14 – 15.

³² Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 15.09.2010 faqet 18 – 19.

Më në fund, i pyetur lidhur me një mesazh SMS tjetër (“E kaluam hapin e pare, u kualifikuam”) dërguar numrit mobil 044 999 666, i pandehuri deklaroi se mesazhi mund të kishte qenë lidhur me privatizimin e Hotelit “Onix”, pasi që kishte një marrëveshje me Agim Elshanin³³.

Bajram MEHMETAJ

I pandehuri *Bajram MEHMETAJ* në deklaratën e tij para Trupit Gjykses e konfirmoi versionin e dhënë nga Muhamet Demaj.

Bajram Mehmetaj specifikoi se kur e kuptoi se nuk ishte e mundur të blihen aksionet ai ishte dëshpërua, por, pasi që nuk kishte humbur para, ai nuk ndërmori asgjë për të siguruar kompensimin.³⁴

Pastaj Naimi vullnetarisht i propozoi Muhamet Demajt që t’ia epte atij 150.000 € sipas kodit shqiptar të etikës lidhur me premtimin që e kishte bërë i cili nuk mund të realizohej. I pandehuri deklaroi para Trupit Gjykses se marrëveshja për pjesëmarrje në tender ishte në mes tij, Muhamet Demajt dhe Naim Hajrizit.

Duke u ballafaquar me përmbajtjen e deklaratës së tij të dhënë në polici me 01.03.2010³⁵, ai mohoi të kishte përmendur emrin e Azem Veselit si një nga pjesëmarrësit në marrëveshje.

Kur është pyetur se pse nuk ia ka kthyer paratë Naimit atëherë kur ia ka kërkuar paratë, i pandehuri ka thënë që ata nuk kishin pasur ndonjë dëshmi që Ekrem Lluka me të vërtetë ishte tërhequr nga tenderi.

Pas ballafaqimit me deklaratën e mëparshme para prokurorit, i pandehuri ka thënë që pas takimit të fundit me Naim Hajrizin ishte vendosur që ti kthehen paratë Naimit, por ata nuk kishin arritur ta bënin këtë sepse të nesërmen ishin arrestuar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Avokati juaj Mbrojtës vetëm sa më përkujtoi që ju keni qenë në liri për 16 ditë, pse nuk ia ke kthyer paratë gjatë atyre 16 ditëve, ju keni qenë plotësisht i lirë?

Bajram Mehmetaj: Vëllezërit dhe motrat e mi dhe disa të tjerë kanë qenë këtu nga jashtë shteti dhe të jem i singjertë kam kaluar kohë me ta dhe nuk kam pasur kohë të dalë as në rrugë.

Kryetari Trupit Gjykses: Lëre tani Bajram Mehmetaj ti ke qenë në gjykim dhe ti ke zgjedhur të kalosh kohë me familjen tuaj, nuk ka kuptim.

Bajram Mehmetaj: Unë nuk kam dashur të kontaktoj ata sepse do të ishte përdorë kundër ne në gjykatë.³⁶

Sa i përket mesazheve lidhur me numrin e telefonit 044 940 046, i pandehuri ka pranuar që numri më lartë ishte i tij. Sa i përket mesazhit (“*Urime, Urime*”) dërguar atij nga Muhamet Demaj me 11 Nëntor 2009, i pandehuri nuk ka qenë në gjendje të jap ndonjë shpjegim.

³³ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 15.09.2010 faqet 19 – 20.

³⁴ Procesverbali i Gjykimit Kryesor të datës 25.08.2010 faqja 21.

³⁵ *Unë së bashku me shokët e mi: Muhamet Demaj dhe Azem Veseli kemi pasur një marrëveshje me Ekrem Llukën përmes personit me emër Naim Hajrizi me të cilën marrëveshje pas privatizimit të Hotelit Onix ai do të na paguante shumën e 150000 Euro sikurse ishim pajtuar para privatizimit.*

³⁶ Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të datës 25.08.2010, faqe 27.

Azem VESELI

I pandehuri Azem Veseli në deklaratën e tij para trupit gjykues ka konfirmuar versionin e dhënë nga dy të pandehurit tjerë.

Ai ka shtuar që njëherë ka takuar Naim Hajrizin në barin Nositi, derisa ishte duke pirë kafe me Muhamet Demajn dhe Bajram Mehmetajn, por nuk ka folur me të dhe se nuk e kishte kuptuar që Muhameti dhe Bajrami ishin duke folur me Naimin.³⁷

I pandehuri mohon të ketë takuar Naim Hajrizin përsëri.

Sa i përket tenderit për Hotelin Onix në Banjën e Pejës, i pandehuri ka deklaruar që ai nuk ka ditë asgjë për këtë tender.

Azem Veseli, Muhamet Demaj dhe Bajram Mehmetaj ishin shokë të luftës dhe për këtë arsye ata ishin shoqëruat së bashku. Demaj dhe Mehmetaj ishin ushtarë gjatë luftës në brigadën e njëjtë ku ai ishte Komandant.

I pandehuri konfirmon që numri i telefonit të tij ishte 044 125 003. Sa i përket mesazhit (“*E morëm*”) të dërguar atij nga Muhamet Demaj me 11 Nëntor 2009, i pandehuri ka deklaruar që ai nuk e ka lexuar apo parë.³⁸

Prova dhe të dhëna shtesë të siguruara gjatë seancave të shqyrtimit kryesor

Trupi Gjykues kishte vendosur *ex officio* të marr në pyetje disa punëtor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe kishte ftuar Klara Bokshin – Oficere Veprimi në AKP, Armend Susurin – Shef i Marketingut në AKP dhe Nora Kelmendin – Drejtoreshë e Departamentit të Shitjes në AKP. Gjatë seancës së 12 Gushtit 2010 trupit gjykues siguroi *ex officio* dokumentet lidhur me procedurën e privatizimit që ishin sjellë në Gjykatë nga dëshmitarja Klara Bokshi³⁹.

Për më tepër, trupi gjykues ka lëshuar *ex officio* tre urdhra:

- Urdhër për kopjimin e dosjes së lëndës nga Agjencia Kosovare e Privatizimit lëshuar me 16.08.2010 sa i përket procedurës së privatizimit për Hotel Onix në Banjën e Pejës;
- Urdhër për zbulimin e të Dhënave Financiare lëshuar me 17.08.2010 lidhur me llogaritë bankare të Ekrem Llukës, Naim Hajrizit, Fatos Zajmit dhe kompanisë Dukagjini për një periudhë nga 1 Nëntori deri me 31 Dhjetor 2009; dhe
- Urdhër për listingun e thirrjeve telefonike dhe tekst mesazheve lëshuar me 25.08.2010 lidhur me numrat e celularëve të Muhamet Demajt, Azem Veselit, Bajram Mehmetaj, Naim Hajrizi, Ekrem Lluka dhe Agim Elshani për periudhën nga 1 Nëntori 2009 deri me 1 Mars 2010.

Përmes urdhrimit të parë trupi gjykues siguroi dokumente lidhur me procedurën e privatizimit të Hotelit Onix në Banjë të Pejës dhe një CD që përmbante dokumente sa i përket procedurës së përmendur lartë⁴⁰.

³⁷ Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të datës 25.08.2010, faqe 31-32.

³⁸ Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të datës 15.09.2010, faqe 23.

³⁹ Dosja e Lëndës së Shqyrtimit Kryesor, Vëllimi II aneksi 3 (pjesa e dytë)

⁴⁰ Dosja e Lëndës së Shqyrtimit Kryesor, Vëllimi II aneksi 3 (pjesa e parë)

Përmes urdhrorit të dytë, janë siguruar të dhëna financiare për llogaritë bankare që i përkasin Ekrem Llukës, Naim Hajrizit, Fatos Zajmit dhe kompanisë Dukagjini⁴¹.

Përmes urdhrorit të tretë, janë siguruar listat e thirrjeve telefonike dhe tekstet e mesazheve⁴².

(të dhënat janë në dispozicion në dosjen e shënuar, Vëllimi II, aneksi 2 pjesa 1 dhe 2).

Trupi Gjykses gjithashtu ka vendosur *ex officio* për të ekzaminuar edhe një herë palën e dëmtuar Ekrem Llukën, dhe dëshmitarin Agim Elshanin.

Gjykata *ex officio* ka kërkuar dosjen penale të pandehurit nga Gjykata e Qarkut në Pejë dhe ka dalë që i pandehuri nuk është dënuar kurrë më parë.

E. VLERËSIMI I PROVAVE TË PARAQITURA DHE KUALIFIKIMET LIGJORE

1. Gjetjet faktike dhe ekzaminimi i provave.

Pas paraqitjes së dëshmive dhe deklaratave të përmendura lartë, sa i përket rekonstruksionit të ngjarjeve të rëndësishme për rastin aktual, pikat që vijnë mund të konsiderohen si të vërtetuara dhe pa dyshim, bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve, pranimet e të pandehurve dhe provat dokumentare në dosje të lëndës:

- Me 21.11.2009 ka ndodhur takimi mes Ekrem Llukës dhe Muhamet Demajt në lokalet e Hotel Dukagjinit në Pejë, lidhur me blerjen e Hotel Onyx;
- Të njëjtën ditë, Ekrem Lluka ka dhënë deklaratë në polici ku ai ka pohuar që ishte kërcënuar nga Demaj;
- Me 23 Nëntor 2009, Fatos Zajmi ka dorëzuar në AKP në Prishtinë një njoftim ku thuhet që Ekrem Lluka, disa ditë më parë, ishte kërcënuar sa i përket blerjes së Hotelit Onyx. Njoftimi ishte nënshkruar nga Fatos Zajmi në emër të Ekrem Llukës;
- Rreth Dhjetorit 2009, Naim Hajrizi i ka dhënë Muhamet Demajt 75.000 Euro (arsyeja për këtë do të analizohet më pastaj) me marrëveshje që pasi të përfundohet procedura e tenderit, edhe 75.000 Euro tjera do të i jepen Demajt;
- Me 15 Shkurt 2010, njoftimi i dytë është dorëzuar në AKP në Prishtinë nga Fatos Zajmi me autorizimin e Ekrem Llukës; njoftimi i përmendur që personat e njëjtë të cilët kishin kërcënuar Ekrem Llukën në Nëntor ende ishin duke kërcënuar atë dhe se Lluka kishte pranuar kërcënime tjera nga njerëz të panjohur lidhur me tender; për më tepër ai ka manifestuar dëshirën e tij që të tërhiqet nga tenderi dhe ka kërkuar që ti kthehen paratë (2.165.133 Euro) që i ishin dhënë AKP;
- Me 28 Shkurt 2010 është bërë një takim në godinën e Hotel Dukagjinit në mes Ekrem Llukës, Naim Hajrizit dhe Muhamet Demajt lidhur me blerjen e Hotel Onyx;

⁴¹ Dosja e Lëndës së Shqyrtimit Kryesor, Vëllimi II aneksi 1.

⁴² Dosja e Lëndës së Shqyrtimit Kryesor, Vëllimi II aneksi 2 pjesa 1 dhe 2.

- Të njëjtën ditë dy takime tjera kanë ndodhë: i pari ku ishin të pranishëm Naim Hajrizi, Muhamet Demaj dhe Bajram Mehmetaj; i dyti nga personat përmendur lartë dhe Azem Veselaj;
- Me 1 Mars 2010 AKP ka refuzuar kërkesën e Llukës për tërheqje nga tenderi dhe kthimin e parave të paguara;
- Me 2 Mars 2010 njoftimi i tretë është dorëzuar në AKP nga Fatos Zajmi duke përmendur që me 28 Shkurt 2010 Ekrem Lluka kishte pranuar kërcënime tjera nga “personi i njëjtë, Muhamet Demaj dhe grupi i tij, i cili kërkonte 75.000 Euro si shantazh lidhur me blerjen e Hotel Onyx”; në letër dëshira e Ekrem Llukës për tërheqje nga tenderi ishte rikonfirmuar dhe ishte kërkuar që AKP të ri-konsideroj vendimin e tyre të datës 1 Mars 2010;
- Me 8 Qershor 2010 proceduar e tenderit ishte anuluar për shkak të dështimit të ofertuesit të tretë (ofertuesi i dytë ishte gjykuar i papranueshëm) të paguaj dhe si pasojë paratë tashmë të paguara nga Ekrem Lluka i ishin kthyer atij;

Rrethanat e përmendura më lartë duken të qarta dhe të pakontestuara nga palët. Ajo çfarë kontestohet është nëse janë bërë kërcënime serioze apo jo të adresuara kundër Ekrem Llukës dhe nëse po, për çfarë arsye janë bërë kërcënimet.

Pala e dëmtuar deklaron që në takimin e mbajtur me 21 Nëntor 2009, Muhamet Demaj, pas pretendimit të tij që ai dhe grupi i tij të kenë 15 % të aksioneve të Hotelit Onyx, ka thënë fjalët që vijojnë, pas refuzimit të Llukës të shes aksionet:

*“Nuk është vetëm thyerja e dritareve që ne dimë të bëjmë” (apo “Ne nuk thyejmë vetëm dritare”) dhe “Ju paralajmëroj”.*⁴³

Para trupit gjykues pala e dëmtuar ka deklaruar që ai nuk është ndjerë i kërcënuar nga fjalët e përmendura më lartë.⁴⁴

⁴³ Procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe 6.

⁴⁴ Procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe 9-10.

Kryetari i Trupit Gjykues: a e keni perceptuar këto fjalë si kërcënim apo jo?

Ekrem Lluka: Unë nuk e kam marrë atë si kërcënim dhe nuk kam qenë i frikësuar, nëse do të isha i frikësuar atëherë duhet të mbylli biznesin dhe ta lëshoj Kosovën.

Kryetari Trupit Gjykues: po, por në Dhjetor ju e keni marrë sjelljen e përgjithshme të Metit si kërcënim. Ju keni thënë me 18 Dhjetor 2009, jam këtu për shkak të kërcënimeve të bëra nga Muhamet Demaj lidhur me pazarin tim dhe privatizimin nga AKM.

Ekrem Lluka: është e vërtetë që pas takimit me Metin kam shkuar në polici, por nëse do të ishte kërcënim dhe unë do të frikohesha atëherë unë do të kërkoja mbrojtje nga policia.

Kryetari i Trupit Gjykues: unë jam duke të ballafaquar me atë që ti ke thënë se nuk i ke marrë ato fjalë si kërcënim. Kurse në Dhjetor ti ke thënë që ka pasur kërcënime të bëra nga Meti kundër jush dhe sa i përket tenderit të këtij hoteli ti ke thënë, për më tepër, “...që nga koha kur jam kërcënuar unë nuk kam pasur kërcënime tjera”, kuptimi është shumë i qartë. Pavarësisht mendimit të Avokatit Mbrojtës unë prapë ju përkujtoj për obligimin që ke si dëshmitar dhe për faktin që dhënia e dëshmisë së rreme është vepër e rëndë penale. Pra këtu keni folur rreth kërcënimeve.

Ekrem Lluka: Unë nuk e kuptoj si unë do të shkoja në polici dhe do të thoja që e kam pasur një bisedë me Metin dhe se kam kërcënime, si mund ta them ndryshe, ndoshta në Shqipëri nuk kemi ndonjë fjalë tjetër, ndoshta në Anglisht është ndonjë fjalë tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykues: ne nuk jemi këtu të supozojmë. Ju ballafaqoj në atë bazë se në Dhjetor ti ke folur për kërcënim, kërcënimi është kërcënim; kuptimi është i qartë.

Megjithatë, në të njëjtën ditën të takimit, Ekrem Lluka ka shkuar në polici dhe ka lëshuar një deklaratë duke pohuar që ai ishte kërcënuar nga një person i quajtur meti (*dmth.* Muhamet Demaj).⁴⁵

Për më tepër me 23 Nëntor 2009, vetëm dy ditë pas takimit, është bërë një njoftim në emër të Ekrem Llukës në AKP. Në këtë njoftim qartë është përmendur që gjatë takimit të mbajtur me 19 Nëntor disa kërcënime janë adresuar kundër Ekrem Llukës.

Dhe në fund me 18 Dhjetor 2009 Ekrem Lluka i ka dhënë policisë një deklaratë të mëtutjeshme në të cilën ai prapë ka pohuar që me 21 Nëntor ai është kërcënuar.⁴⁶

Prandaj, sa i përket fjalëve të përmendura më lartë nga Demaj, veprimi i ndërmarrë nga pala e dëmtuar qartë tregon që kërcënime në të vërtetë janë bërë kundër tij dhe se ai është ndjerë i kërcënuar.

Ky përfundim vërtetohet nga deklaratat e dhëna nga Naim Hajrizi gjatë hetimeve.

Në të vërtetë, edhe pse, para Gjykatës dëshmitari ka deklaruar që ai ka pasur biseda me Muhamet Demajn dhe Bajram Mehmetajn sa i përket dëshirës së tyre të blejnë 10% të aksioneve të hotelit Onyx, por ka mohuar që kërcënimet janë bërë nga dy të pandehurit, përmbajtja e deklaratës së dhënë nga Hajrizi me 1 Mars 2010 në polici është tërësisht ndryshe dhe rezulton siç vijon nga fragmente të marra nga procesverbali i 5 Gushtit 2010:

Kryetari i Trupit Gjykses: nuk është e qartë 100%. A kanë dashur të kenë pjesë në pronësinë e hotelit?

Naim Hajrizi: po.

Kryetari i Trupit Gjykses: sa ka qenë përqindja e kësaj pjese?

Naim Hajrizi: 10%

Prokurori Publik: ujdia ka qenë që ata do të paguajnë këtë 10%?

Naim Hajrizi: po.

Prokurori Publik: dhe a ndodhi kjo?

Naim Hajrizi: jo.

Prokurori Publik: pse?

Naim Hajrizi: sepse shoku im nuk kishte nevojë për ndonjë aksionar.

Ekrem Lluka: atë çka kam folur me Metin unë e kam ndjerë si obligim si qytetar ta raportoj në polici dhe unë jam duke u treguar për çka kemi folur dhe pas kësaj e kam raportuar rastin në polici.

Kryetari i Trupit Gjykses: po, ti e ke raportuar në polici sikur të ishte kërcënim. Tani pasi ua freskoj kujtesën ende e mohoni që në Dhjetor ju jeni ndjerë i kërcënuar nga sjellja e Muhamet Demajt?

Ekrem Lluka: Unë nuk jam ndjerë i kërcënuar, unë jam ndjerë që duhet të shkoj të raportoj në polici.

⁴⁵ Procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe 5-6:

Kryetari i Trupit Gjykses: ndoshta mund të ju ndihmoj tua freskoj kujtesën; jam duke cituar deklaratën që ke dhënë në polici në ditën e njëjtë të këtij takimi prandaj jam duke supozuar që kujtesa juaj atëherë ka qenë e qartë.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: ti ke thënë që gjatë bisedës pasi ti ke refuzuar, personi është kërcënuar me fjalët "mos mendo që ne vetëm dimë të thyejmë dritare". Pra sipas asaj çka i ke thënë policisë kjo fjali është thënë pasi ju keni refuzuar të jepni 15% të aksioneve? A është kjo në përputhje me kujtesën tuaj?

Ekrem Lluka: po, ai ma ka thënë këtë në fund.

Kryetari i Trupit Gjykses: a jeni përgjigjur në ndonjë mënyrë?

Ekrem Lluka: jo.

⁴⁶ Procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe 9.

Prokurori Publik: cili ishte reagimi i tyre?

Naim Hajrizi: ishte i rëndomtë, biseda të zakonshme, duke bërë me dije dhe duke thënë se ai nuk do mund të paguaj të tërën pasi ishte 8 milion e gjysmë, gjëra të tilla, muhabeti i rëndomtë ditor.

Kryetari i Trupit Gjykses: por Prokurori Publik është duke thënë, pasi Ekrem Lluka ka thënë nuk kam nevojë për aksionarë, çka kanë bërë, a kanë thënë vetëm mirë, faleminderit dhe mirupafshim apo kanë thënë diçka tjetër?

Naim Hajrizi: ishte mënyrë e thjeshtë e muhabetit. Ata kanë ardhur me një ide që aksionet e partnerit Slloven dhe të Ekrem Llukës po ashtu duhet të zvogëlohen pasi ata do të hyjnë dhe do të marrin aksionet tjera sepse ata ishin nga ai rajon.

Kryetari i Trupit Gjykses: por pasi Ekrem Lluka i kishte refuzuar ata, cili ishte reagimi i tyre, këtë dëshiron ta dijë Prokurori Publik. Ne jemi duke shkuar rreth kësaj për 5 minuta. Dil te çështja.

Naim Hajrizi: nuk kishte reagim. Pasi isha shok i Ekrem Llukës unë mund të influencoja, kjo ishte e tëra. Kishte raste këtu në Pejë dhe tjetërkund kur njerëzit bëheshin bashkë, 6 apo 7 tjerë bëheshin aksionar dhe ata kanë menduar se ky do të ishte rasti këtu po ashtu.

Kryetari i Trupit Gjykses: Unë e shoh që ju nuk jeni duke u përgjigjur këtu po ashtu. Atë që e keni thënë para policisë, para se të ballafaqohesh me deklaratë, a kanë thënë këta njerëz ndonjëherë kërcënim kundër jush apo Ekrem Llukës sa i përket tenderit apo të marrin një pjesë të pronësisë të hotelit?

Naim Hajrizi: Nuk do të isha në gjendje të them këtë.

Kryetari i Trupit Gjykses: pasi nuk jeni në gjendje atëherë unë do të ju ballafaqoj me atë që e keni thënë në polici me 1 Mars 2010. Ju keni thënë "Unë kam qenë i angazhuar prej fillimit në biseda që janë bërë nga Ekrem Lluka dhe një grup të njerëzve që përbëhej nga Muhamet Demaj, Bajram Mehmetaj dhe Azem Veseli. Fillimisht këta njerëz kërkonin 10% të vlerës totale të vendit. Por pas shumë negociatave, frikësimeve dhe shantazheve të bëra dhe të adresuara ndaj Ekrem Llukës, ne kemi arritur të i ofrojmë shumën e 150,000 Euro këtyre njerëzve e cila ishte pranuar nga ta po ashtu". Tani e kupton çka është qëllimi i deklaratave të dhëna gjatë hetuesisë, është vetëm të shihet nëse dëshmitari është duke gënjyer apo jo, e jo të ju kursejmë nga kënaqësia e paraqitjes këtu. Tani pasi e lexova me zë atë se çka i ke thënë policisë, a ju kujtohet apo jo?

Naim Hajrizi: deklarata e njëjtë që kam dhënë në polici është ajo që vetëm sa e dhashë tani.

Kryetari i Trupit Gjykses: jo, së pari, ti nuk je këtu të vlerësosh deklaratën tënde të mëhershme; e dyta, ti nuk ke thënë të njëjtën gjë. Ti ke thënë se nuk ke marr, ti apo Ekrem Lluka, nuk keni marrë ndonjë kërcënim. Ndërsa këtu ti ke folur për frikësim dhe bile shantazh. Cila është kujtesa juaj. A është e vërtetë që pas disa negociatave, frikësimeve dhe shantazheve ti dhe Ekrem Lluka vendosët të u jepni këtyre njerëzve 150,000 Euro?

...

Naim Hajrizi: Unë nuk e kam thënë këtë para policisë.

...

Naim Hajrizi: kjo ka rezultuar nga bisedat që unë kam pasur privatisht me këta tre njerëz, Bajram Mehmetaj, Metin dhe unë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Bajram Mehmetaj dhe Muhamet Demaj?

Naim Hajrizi: Bajram Mehmetaj dhe unë vet. Dhe Azem Veseli ndonjëherë, aty dhe këtu.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: pra kur keni folur për frikësim dhe shantazh, asnjëra nga to nuk janë bërë në prani të Ekrem Llukës?

Naim Hajrizi: ato nuk janë bërë as para meje, lëre më para Ekrem Llukës, sepse ai nuk ka qenë i pranishëm kur unë jam takuar me këta njerëz.

Kryetari i Trupit Gjykses: pra kur flisni këtu në këtë deklaratë rreth frikësimit dhe shantazhit të kryer nga ky grup i njerëzve, a kanë qenë këto veprime të kryera vetëm para jush?

*Naim Hajrizi: ato nuk kanë ekzistuar fare.*⁴⁷

Është me rëndësi të konstatohet që të dy Lluca dhe Hajrizi kanë ndryshuar gjerësisht versionet e tyre të ngjarjes kur ata u intervistuan nga Prokurori me 18 Mars 2010; në fakt, ndryshe nga ajo çka kanë deklaruar para policisë në Nëntor 2009, të dy ata deklaruan që nuk ka pasur kërcënime të adresuara kundër Llukës nga Muhamet Demajt.

Në mënyrë që të vlerësohet nëse fjalët janë ndjerë si kërcënim nga Lluca apo jo, duhet të merret parasysh që Naim Hajrizi rreth Dhjetorit 2009 i ka dhënë Muhamet Demajt 75.000 Euro.

Cila ka qenë arsyeja që janë dhënë këto para?

Naim Hajrizi ka thënë para Gjykatës që paratë janë dhënë si një formë e kompensimit për tërheqjen e Demajt nga kërkesa lidhur me Hotel Onix, siç shihet nga fragmenti që vijon.⁴⁸

Naim Hajrizi: e kam bërë një ujdë – ne kemi arritur një ujdë që ata të tërhiqen nga interesi i tyre që të participojnë me 10%. U kam premtuar që do të ju ndihmoj për punësim pasi ata janë me origjinë nga ai rajon, por ata kanë thënë pse të punojnë pa aksione, pastaj kam vendosur të bëjmë pazar për 75,000 Euro në çështje.

Kryetari Trupit Gjykses: a ka qenë marrëveshja për 75,000 apo për 150,000?

Naim Hajrizi: 150,000.

Kryetari i Trupit Gjykses: a mund të shpjegoni pse është dashur të u jepni atyre 150,000 Euro për hiçgjë sepse ata nuk kanë pasur të drejtë të marrin këto para. Tingëllon shumë çuditshëm.

Naim Hajrizi: duke filluar nga jeta dhe puna ku jetojmë, për shembull, ju i merrni 10% të aksioneve, ia mundësoni dikujt të merr 10% dhe pas një viti ai mund të vij dhe mund të thotë nuk i dua, i shes aksionet e mia. Ai pastaj vjen ndoshta me dyfishin e çmimit fillestar...

Kryetari i Trupit Gjykses: por ata nuk kanë pasur të drejtë të asgjë, pra ua keni dhënë 75,00 Euro falas. A ka ndodhë kështu?

Naim Hajrizi: në mënyrë që ata të mos kenë ndonjë aksion.

Kryetari i Trupit Gjykses: ti ke paguar në emër të Ekrem Llukës pasi ai ka qenë fitues i tenderit apo keni paguar spontanisht?

Naim Hajrizi: e para ai ka qenë fitues i tenderit dhe e dyta ishte kënaqësi e imja që ai ishte fitues i tenderit dhe e treta sepse unë kam pasur dijeni lidhur me investimin që do të ndodhin në të ardhmen, e kam konsideruar nga këndi im që të rregulloj këtë marrëveshje në mënyrë të tillë.

Kryetari i Trupit Gjykses: pra ishte ideja juaj?

Naim Hajrizi: po.

Ndërsa, arsyeja pse paratë i janë dhënë Demajt nga Hajrizi është shpjeguar nga Ekrem Lluca siç vijon:

Ekrem Lluca: Naim Hajrizi më ka thënë se ai ia kishte dhënë Metit 75,000.

Prokurori Publik: A të ka dhënë shpjegim pse ka paguar 75,000?

Ekrem Lluca: Po, ai ka shpjeguar se ata dëshironin të bashkoheshin si aksionar dhe në mënyrë që të qetësohet situata unë vendosa të jap 75,000.

Prokurori Publik: Kur thua “Unë” a mendon Naim Hajrizi?

*Ekrem Lluca: Po.*⁴⁹

⁴⁷ Procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe 34-37.

⁴⁸ Procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe 37-38.

⁴⁹ Procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe 15.

Sipas versionit të dhënë nga të pandehurit Muhamet Demaj dhe Bajram Mehmetaj, Hajrizi i kishte premtuar Muhamet Demajt 10% të aksioneve të Hotel Onix dhe pasi ai nuk kishte pasur mundësi të i përmbahej këtij premtimi, ai spontanisht kishte ofruar 150.000 Euro si kompensim sipas rregullave të traditës Shqiptare.⁵⁰

Në veçanti Demaj ka mohuar të ketë thënë ndonjë fjalë kërcënuese dhe ka shtuar që marrëveshja ishte me Ekrem Llukën dhe se Naim Hajrizi ka vepruar si ndërmjetësues.⁵¹

⁵⁰ Procesverbali i 25 Gushtit 2010, faqe

Bajram Mehmetaj: Shoku im Muhamet Demaj ka kontaktuar Naim Hajrizin dhe Muhamet Demaj më ka kontaktuar mua dhe gjatë bisedës sonë ai më ka thënë se është në kontakt me Naim Hajrizin dhe se ka bërë një propozim për të blerë disa aksione të Hotel Onix. Pastaj unë dhe Muhamet Demaj jemi takuar më shumë se një herë. Më vonë Muhamet Demaj kishte kontaktuar me Naim Hajrizin gjatë cilit takim unë nuk kam qenë i pranishëm; Naim Hajrizi kishte premtuar që ai do të bëhej pjesëmarrës dhe do të blej 10% të aksioneve. Pastaj Muhamet Demaj më ka propozuar që të bëhem pjesëmarrës i atyre 10% sepse ai nuk kishte mjete të mjaftueshme dhe unë pritja me ëndje që të pranohet një ofertë të tillë, natyrisht.

...

Prokurori Publik: Pastaj çfarë ndodhi, i bleve këto 10% apo?

Bajram Mehmetaj: Jo.

Prokurori Publik: Pse?

Bajram Mehmetaj: Sepse ishte Naim Hajrizi ai që dështoi.

Prokurori Publik: A mund të na jepni detaje ju lutem?

Bajram Mehmetaj: Unë nuk di shumë nga detajet por e di që ishte Naim Hajrizi i cili tha "unë nuk mundem ta mbaj premtimin që të ju mundësoj që të bëheni pjesëmarrës në këtë tender".

Prokurori Publik: a ke qenë i pranishëm kur Naim Hajrizi e ka bërë këtë premtim?

...

Bajram Mehmetaj: Jo nuk kam qenë i pranishëm në takimin e parë.

Prokurori Publik: A ke qenë i pranishëm kur ai ka thënë se nuk mund të organizoj shitjen e këtyre 10%?

...

Bajram Mehmetaj: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ishte i pranishëm?

Bajram Mehmetaj: Ishte Muhamet Demaj.

Kryetari i Trupit Gjykses: Cili ishte reagimi juaj, çka ndodhi?

...

Bajram Mehmetaj: Po, gjatë njëres prej atyre ditëve Naim Hajrizi i propozoi Muhamet Demajt një shumë të parasë dhe ishte propozuar vullnetarisht thjesht sipas kodit të etikës Shqiptare sa i përket premtimit origjinal të bërë; që thjesht do të thotë që nëse dikush jep premtim, ai premtim duhet të respektohet dhe nëse dikush nuk mund ta mbaj fjalën atëherë ai person duhet të jap diçka si shpërblim në mënyrë që të kompensoj apo të përmbush veprën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Cila ishte oferta e Naim Hajrizit?

Bajram Mehmetaj: Naim Hajrizi ka ofruar 150000 Euro.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dhe çka keni bërë?

Bajram Mehmetaj: Muhamet Demaj ma ka shpjeguar dhe ai e ka pranuar.

⁵¹ Procesverbali i 15.9.2010, faqe 20-21.

Muhamet Demaj: sa i përket pjesëve të caktuara të deklaratës sime të seancës së kaluar, dua të shtoj disa gjëra specifike që të mos harrojmë asgjë. Është e vërtetë që gjatë hapjes së tenderit për Banjën e Pejës, unë kam shfaqur interesimin të hyj në një marrëveshje me cilindo ofertues për Hotel Onix. Kisha për qëllim të blej një numër të caktuar të aksioneve. Gjatë asaj kohe arrita të bëj një marrëveshje me Agim Elshanin lidhur me 15% të aksioneve. Po ashtu kam arritur të bëj një marrëveshje me Ekrem Llukën përmes Naim Hajrizit, ndërmjetësues i tij.

Kryetari i Trupit Gjykses: a ishte kjo marrëveshje me Ekrem Llukën pasi ai kishte fituar tenderin apo ka ndodhë para tenderit?

Muhamet Demaj: para se ai të fiton tenderin.

Kryetari i trupit Gjykses: Cilat ishin kushtet e marrëveshjes me Ekrem Llukën?

Në këtë xhungël të versioneve që bien ndesh, disa konsiderata mund të bëhen.

Duket shumë e pamundur që në takimin e mbajtur me 21 Nëntor 2009 në mes Ekrem Llukës dhe Muhamet Demajt nuk janë përmendur kërcënimet kundër Llukës dhe se sjellja e përgjithshme që ka mbajtur ky i fundit nuk është perceptuar nga pala e dëmtuar si kërcënuese.

Përndryshe, sjellja e Llukës, i cili në të njëjtën ditë ka deklaruar para policisë se ai ishte kërcënuar, dhe vetëm dy ditë më vonë, ka dorëzuar një njoftim në AKP duke i informuar Agjencinë lidhur me kërcënimet, do të ishte me të vërtetë qesharake dhe e pashpjegueshme.

Është e qartë që trupi gjykues ka konsideruar mundësinë që Lluka të kishte disa sajuar kërcënimet në mënyrë që ti lejohet të tërhiqet nga tenderi, pa i humbur paratë e paguara tashmë si fitues provizor; megjithatë ky opsion duket të jetë pak i mundshëm, pasi në Nëntor 2009 Lluka nuk ka kërkuar nga AKP të tërhiqet nga tenderi por thjesht e ka informuar Agjencinë lidhur me kërcënimet që ai ka marrë (këto qëllime të tilla do të lajmërohen vetëm pas tre muajve, me njoftimin e dytë të dorëzuar në AKP me 15 Shkurt 2010).

Është e qartë që shprehjet sikur “*Ne nuk dimë vetëm të thyejmë dritare*” dhe “*Ju paralajmëroj*” në kontekstin në të cilin janë shprehur (dmth. Pretendimet sa i përket pjesëmarrjes në aksione të Hotel Onix) duhet të konsiderohen si kërcënime serioze në kuptimin që ato ishin të mjaftueshme për të detyruar vullnetin e Ekrem Llukës që ti jap para Muhamet Demajt në mënyrë që ti ikë ndonjë problemi të mundshëm.

Duhet të merret parasysh po ashtu fakti që Lluka është një ndërmarrës i njohur në Kosovë me disa aktivitete dhe do të ishte e natyrshme që ai të jetë i brengosur lidhur me veprimin mundshëm kundër aktiviteteve të shumta të tij.

Për më tepër, në deklaratën e tij para policisë Hajrizi ka folur qartë rreth frikësimit dhe shantazheve të cilat kanë shpjerë deri te marrëveshja për dhënien e 150.000 Euro. Prandaj është shumë e mundur që veprimi i ndërmarrë nga të pandehurit ka shkuar përtej fjalëve të përmendura lartë dhe se ata kanë kryer veprime tjera për të shtrënguar vullnetin e Llukës.

Dhe që kërcënimet kanë qenë efikase dhe serioze mund të përfundohet po ashtu nga konsiderimi që, pavarësisht deklaratave të bëra nga Lluka⁵² dhe Hajrizi⁵³ (i cili e

Muhamet Demaj: në të vërtetë unë kam arritur marrëveshje përmes ndërmjetësuesit të tij. Unë i kam sugjeruar një marrëveshje për 15% të aksioneve megjithatë gojarisht ne kemi arritur të bëjmë marrëveshje për 10% vetëm në bazë të çmimit të blerjes. Qëllimi im ishte gjithmonë që të bëhem partner i cilitdo që do ta blej hotelin prandaj unë e kam pasur qëllimin të bëj marrëveshje me të dy, duke marrë në konsideratë që njëri nga ta do të kishte mundësi të kompletonte blerjen. Pasi ofertat ishin të hapura, Ekrem Lluka ishte fitues. Pas kësaj unë kam qenë subjekt i presionit nga Naim Hajrizi ndërmjetësues i Ekrem Llukës që të tërhiqem nga blerja e 10% të aksioneve që korrespondonte me tërheqjen nga marrëveshja që ne kishim arritur. Pas presionit që kisha nga Naim Hajrizi në mënyrë nxitëse nga jo realizimi i marrëveshjes së arritur më herët ai ofroi një kompensim prej 150.000 Euro ku unë e pranova ofertën.

⁵² Procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe 15:

Ekrem Lluka: Ai ka dhënë para në emër timin, unë nuk kam paguar.

mbështet atë që pagesa është bërë spontanisht nga ky i fundit), në të vërtetë duket që Lluka ka qenë burimi i parasë.

Në të vërtetë siç mund të shihet në procesverbalin e raportuar në fusnotën n. 53, Hajrizi ka pranuar në deklaratën e tij të parë para policisë që paratë i janë dhënë Demajt në emër të Ekrem Llukës.

Dhe se vendimi që të jepen paratë ka ardhur nga Lluka mund të shihet po ashtu nga një pjesë tjetër e deklaratës së njëjtë (dëshmitari ishte ballafaquar sa i përket kësaj pjese të deklaratës) në të cilën Hajrizi konfirmon që ai “*ishte i angazhuar nga fillimi në bisedat që ishin duke u bërë nga Ekrem Lluka dhe një grupi të njerëzve të përbërë nga Muhamet Demaj, Bajram Mehmetaj dhe Azem Veseli. Fillimisht këta njerëz ishin duke kërkuar 10% të vlerës totale të vendit. Por pas shumë negociatave, kërcënimeve dhe shantazheve të bëra në adresë të Ekrem Llukës, ne arritëm të i ofrojmë këtyre njerëzve shumën e 150,000 Euro që ishte pranuar nga ta po ashtu.*”

Është me vlerë të konstatohet që përemri “*ne*” e bën të qartë që pagesa nuk ishte vetëm iniciativë spontane e Hajrizit.

Për më tepër Zbulimi i të Dhënave Financiare e urdhëruar nga kjo Gjykatë gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor ka shpalosur dy tërheqje të parave të gatshme nga llogaria bankare e kompanisë Dukagjini me 8 Dhjetor 2008 (saktësisht në periudhën e pagesës) për shumën e përgjithshme të 75.000 Euro.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Ai ka paguar në emrin tënd, a është ashtu? A ishte besuar ai nga ju apo jo për këtë pagesë?

Ekrem Lluka: Po ai është shok i imi, Unë do të...

Kryetari i Trupit Gjyqësor: A i ishte besuar kjo atij nga ju apo ka paguar spontanisht?

Ekrem Lluka: Më shumë spontanisht.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Ose është spontanisht ose jo?

Ekrem Lluka: Ishte spontanisht.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Ju nuk keni kërkuar nga ai të paguaj?

Ekrem Lluka: Jo.

⁵³ Procesverballi i 5 Gushtit 2010, faqe 38:

Kryetari i Trupit Gjyqësor: a ke paguar në emër të Ekrem Llukës pasi ai ka qenë fitues i tenderit apo ke paguar spontanisht?

Naim Hajrizi: së pari pasi ai ishte fitues i tenderit dhe së dyti ishte kënaqësi e imja që ai ishte fitues i tenderit dhe së treti sepse isha i vetëdijshëm për investimin që mund të ndodhë në të ardhmen, kam konsideruar nga këndi im që të rregulloj këtë marrëveshje në mënyrë të tillë.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: a ishte ideja juaj?

Naim Hajrizi: po.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: është tërësisht ndryshe nga ajo çka ke thënë në polici. Në deklaratën që ke dhënë në polici me 1 Mars 2010 ti ke thënë që pjesën e parë të parave në shumën 75,000 Euro unë personalisht ia kam dhënë Muhamet Demajt, këto para i kam paguar në emër të Ekrem Llukës, që ishte në atë kohë në Slloveni. Pra këtu ke thënë që ke paguar në emër të Ekrem Llukës, dhe tani thua që ke paguar spontanisht? Cili është versioni i vërtetë?

Naim Hajrizi: Mund të them se versioni i vërtetë është që e tërë shumën është paguar nga unë privatisht dhe pas arritjes së marrëveshjes, pas së cilës e kam informuar Ekrem Llukën, i cili nuk kishte dëgjoni për marrëveshjen e tërë.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: kujt ia ke dhënë paratë?

Naim Hajrizi: Metit. Galani ka qenë i pranishëm dhe gjithashtu Azem Veseli rastisi të jetë aty po ashtu.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: i ke paguar paratë në të gatshme apo përmes transferimit bankar, si ke paguar?

Naim Hajrizi: të gatshme.

Në këtë pikë është me rëndësi të konstatohet që palës së dëmtuar, Ekrem Llukës, i është kërkuar që të jap shpjegime lidhur me këto dy tërheqje të parave të gatshme të bëra nga një punonjës i tij (njëfarë Sekibe), ai nuk ka qenë në gjendje të pajis Gjykatën me ndonjë informatë.⁵⁴

Edhe pse Enver Lluka është një ndërmarrës me disa aktivitete, duke e çuditshme që ai nuk mund të kujtonte tërheqjen e parave të gatshme për shumë e cekur të 75,000 Euro që kishte ndodhur para jo shumë kohësh. Kjo është një shenjë shtesë në drejtim të asaj që paratë ishin dhënë nga Hajrizi në emër të Llukës dhe me udhëzim të tij.

Për më tepër përfshirja direkt e Ekrem Llukës (dhe jo vetëm e Naim Hajrizit) në aferë del mu nga fjalët e përmendura nga Bajram Mehmetaj në polici.

⁵⁴ Procesverballi i 15 Shtatorit 2010, faqe 5-6.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju na thatë kur Naim Hajrizi i dha Muhamet Demajt 75,000 Euro, ishte iniciativë e tij; ju nuk e keni ngarkuar atë që tu jap paratë këtyre njerëzve. E konfirmoni këtë?

Ekrem Lluka: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: edhe pse ne mund të kuptojmë që ishte pak e çuditshme që një person jep 75,000 Euro për ju pa thënë asgjë, posaçërisht për një biznesmen. Kush janë njerëzit të cilët janë të lejuar që të tërheqin para për Kompaninë Dukagjini në bankën Raiffeisen?

Ekrem Lluka: Kontabilisti im, Zonja Sekibe Tigani.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo zonjë tërheq para me iniciativën e saj apo me udhëzimet tuaja?

Ekrem Lluka: me udhëzimet e mia.

Kryetari i Trupit Gjykses: ne e kemi që me 8/12/09 është bërë një tërheqje nga ajo prej 25,000 Euro, është në dokumentet që i kemi pajisur palët, dhe në të njëjtën ditë edhe një tjetër, por Sekibe nuk është përmendur. Pra unë supozoj që ju keni tërhequr 50,000 Euro dhe kur të përmbliiden bëjnë 75,000 Euro. A ju kujtohet diçka lidhur me këto tërheqje të bëra me 8.12.09?

Ekrem Lluka: Jo nuk më kujtohet, më duhet ta verifikoj?

Kryetari i Trupit Gjykses: në çfarë mënyre sepse unë mund të ju tregoj dokumentet e dhëna nga banka.

Ekrem Lluka: Sepse ka tërheqje tjera.

Kryetari i Trupit Gjykses: ne nuk jemi të interesuar për paratë e depozituara, por për tërheqjen e 75,000 Euro, që ishte shuma e saktë që ju dha Muhametit. Nuk ka shpjegim vetëm tërheqje të 75,000 para të gatshme dhe e dini se Muhamet Demaj ka thënë që ka marrë para të gatshme. Trupi Gjykses do ta bëjë arsyetimin e tij por kuptoni që ka 75,000 para të gatshme dhe periudha ka qenë gjatë asaj kohe që janë dhënë. Është e çuditshme që dikush japë para pa ndonjë udhëzim. E dini që nëse ka deklaratë të rreme në gjykatë ju do të akuzoheni për dhënie të deklaratës së rreme. Edhe pse jeni person i pasur, tërheqja e 75.000 Euro brenda një dite është para e madhe?

Ekrem Lluka: Më duhet të verifikoj lidhur me këto para brenda kompanisë.

Kryetari i Trupit Gjykses: këto ishin tërheq nga kompania. A doni të shihni dokumentet, Avokati juaj mbrojtës e ka një kopje gjithashtu. Ju lutem afrohuni dhe shikojeni dokumentin. Sekibe ka shkuar në bankë dhe ka tërhequr 25,000 Euro. A ju kujtohet nëse këto 50,000 Euro janë tërhequr nga ju apo Sekibja? Sa i përket 25,000 Euro, dokumenti e bankës thotë që paratë janë tërhequr nga Sekibja, por sa i përket shumës tjetër nuk ka specifikim pra supozoj që ishit ju ai që keni tërhequr paratë.

Ekrem Lluka: Unë kurrë nuk tërheqë para nga banka personalisht.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ka person tjetër që e ka të lejuar tërheqjen e parave përveç Sekibes në kompaninë Dukagjini?

Ekrem Lluka: vetëm Sekibja.

Kryetari i Trupit Gjykses: por ju mund të tërhiqni para, gjithashtu?

Ekrem Lluka: Po. Por kurrë nuk e kam bërë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra, a jeni i sigurt që ju kurrë nuk ia keni dhënë paratë Naim Hajrizit për këta njerëz?

Ekrem Lluka: jam i sigurt.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa i përket pjesëmarrjes në aksionet e hotelit Onyx, marrëveshja ka qenë në mes ju, Muhamet Demaj dhe Naim Hajrizit?

Bajram Mehmetaj: Po, mua, Muhamet Demaj dhe Naim Hajrizi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Mirë, sepse me 01.03.2010 ju keni thënë: “unë së bashku me shokët e mi: Muhamet Demaj dhe Azem Veseli kemi pasur një marrëveshje me Ekrem Llukën përmes një personi të quajtur Naim Hajrizi me të cilën marrëveshje pas privatizimit të Hotel Onyx ai do të na paguante shumën e 150000 Euro siç ishte akorduar para privatizimit.” Këto janë fjalët që ju keni thënë para policisë. Pra me sa duket marrëveshja ka qenë në mes jush, Muhamet Demajt dhe Azem Veselit në njërin anë dhe në anën tjetër Ekrem Lluka dhe Naim Hajrizi.

Bajram Mehmetaj: Jo, kjo nuk është e vërtetë. Oficeri hetues i policisë më ka pyetur kush e ka organizuar këtë marrëveshje dhe unë i kam thënë që ishte Muhamet Demaj dhe Naim Hajrizi. Pyetja tjetër ishte nëse Ekrem Lluka ka pasur dijeni lidhur me këtë (duke iu referuar marrëveshjes) dhe unë ia kam thënë ndoshta. Pse unë, sepse Ekrem Lluka ishte aksionari kryesor.⁵⁵

Për më tepër duket shumë qesharake dhe kundër çdo praktike normale të biznesit që një biznesmen sikur Hajrizi, pasi ka pasur disa biseda apo marrëveshje jo formale lidhur me mundësinë e shitjes së disa aksioneve të Hotel Onyx, të ketë ndjerë i obliguar të paguaj shumën relevante të 150.000 Euro, pa pasur ndonjë obligim formal, vetëm sepse eventualisht blerja nuk mund të ndodhë.

Dhe është edhe më e pabesueshme që ai ka vendosur ti jap krejt paratë pa ndonjë presion nga të pandehurit dhe pa ndonjë udhëzim nga Lluka.

Prandaj trupit gjykses gjykon që kërcënime serioze janë thënë kundërt palës së dëmtuar dhe kjo ka qenë arsyeja kryesore (nëse jo e vetmja) pse Lluka dhe Hajrizi kishin vendosur të premtojnë pagesën e 150.000 Euro dhe ti japin Demajt 75,000 Euro në Dhjetor 2009 në mënyrë që të ndalohen kërcënimet dhe të mos kenë probleme tjera sa i përket blerjes së Hotel Onix.

Sa i përket kërkesës për të paguar 75,000 Euro, pala e dëmtuar⁵⁶ dhe Naim Hajrizi⁵⁷ kanë konfirmuar që në të vërtetë në takimin e më vonshëm me të tre të pandehurit njëri prej tyre ka përmendur që “Nëse paratë nuk paguhen deri të Mërkurën, Peja do të digjet”.

Edhe pse Lluka ka deklaruar para Gjykatës që ai nuk ndjehej i kërcënuar nga këto fjalë⁵⁸ të cila i ishin raportuar atij nga Hajrizi, në anën tjetër, në të njëjtën ditë Lluka ka shkuar në polici dhe ka dhënë deklaratë në të cilën ai ka folur qartë për kërcënimet e bëra nga Demaj dhe grupi i tij dhe se ai është ndjerë i kërcënuar nga sjellja e tij (shiko ballafaqimin e palës së dëmtuar në faqen 18 të procesverbalit të 5 Gushtit 2010.)

Prokurori Publik: A mund të jetë që ai ka thënë diçka sikur: “nëse nuk paguan, Peja do të digjet?” A ju kujtohet që jeni intervistuar nga Policia me 28 Shkurt 2010?

Ekrem Lluka: Po.

⁵⁵ Procesverbal i 25 Gushtit 2010, faqe 22.

⁵⁶ Procesverbal i 5 Gushtit 2010, faqe 18.

⁵⁷ Procesverbal i 5 Gushtit 2010, faqe 46.

⁵⁸ Procesverbal i 5 Gushtit 2010, faqe 22.

Prokurori Publik: Dhe se Naimi ju ka thënë se kishte takuar Metin?

Ekrem Lluka: Po, por nuk më ka thënë atë të diel, më ka thënë më vonë.

Prokurori Publik: Kur?

Ekrem Lluka: rreth orës 5 apo 6 në mbrëmje. Nuk e di kohën e saktë.

Prokurori Publik: Çka të ka thënë?

Ekrem Lluka: Atij i ishte thënë: "nëse paratë nuk paguhen do të digjet Peja flakë".

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju keni thënë këtu në këtë deklaratë: "Më informoi Naimi që Muhamet Demaj së bashku me Azem Veselin dhe Bajram Mehmetajn janë takuar me 27 Shkurt 2010 dhe po ashtu në ditën vijuese, me 28 Shkurt 2010, ku kanë kërkuar shumën shtesë të 75,000 Euro duke u kërcënuar që nëse shuma shtesë nuk paguhet të Mërkurën Peja do të digjet". Kjo është ajo që ke thënë atë ditë.

Ekrem Lluka: Kjo është ajo që më ka thënë Naimi.

Kryetari i Trupit Gjykses: po, ti ke raportuar këtë në polici, e konfirmoni këtë tani?

Ekrem Lluka: po.

Prokurori Publik: "jam ndjerë i kërcënuar nga kjo vizitë dhe nga kërkesat e tij pasi nuk kam obligime ndaj tij dhe kjo është njëfarë lloj shantazhimi..."

Ekrem Lluka: Unë e kam konsideruar kërkesën për para si kërcënim, jo që ka bërë kërcënime të çështjeve të ndryshme. Ai nuk më ka kërcënuar fizikisht apo trupore...

Dhe vetëm dy ditë pas takimit, me 2 Mars 2010, avokati i Llukës ka dorëzuar në AKP një letër në të cilën është përmendur që "Muhamet Demaj dhe grupi i tij" ishin "duke i bërë shantazh Ekrem Llukës përmes kërcënimeve serioze" në mënyrë që të obligojnë atë të paguaj 75.000 Eurot e mbetura.

Prandaj duket e qartë që po ashtu në Shkurt 2010 Lluka ka pranuar kërcënime dhe është ndjerë i kërcënuar nga sjellja e Demajt dhe të bashkëpunëtorëve të tij, por megjithatë kishte vendosur që të mos jap para më.

Sa i përket përfshirjes së të pandehurve në ngjarje, përveç sjelljes së Demajt, i cili fizikisht kishte shprehur kërcënimet dhe kishte pranuar paratë, pozita e Bajram Mehmetaj dhe e Azem Veselit duhet të vlerësohet.

Duket e qartë dhe e padiskutueshme që Mehmetaj ka vepruar në bashkëpunim me Demajn (pasi të dy padyshim kanë bërë ndarjen e parave të pranuar nga Hajrizi) dhe që Mehmetaj ka marr pjesë në të shumtën e takimeve me Hajrizin, duke përfshirë atë në Shkurt në të cilën janë shprehur kërcënime tjera.

Sa i përket përfshirjes së Azem Veselit, pavarësisht nga përpjekja e dy të pandehurve të tjerë që ta lënë anash atë, pozita e tij në ngjarjet është bërë e qartë nga Hajrizi i cili konfirmoi që ai ishte i angazhuar "nga fillimi në bisedime që ishin duke u drejtuar nga Ekrem Lluka dhe një grupi njerëzve të përbërë nga Muhamet Demaj, Bajram Mehmetaj dhe Azem Veseli. Fillimisht këta njerëz ishin duke kërkuar 10% të vlerës së përgjithshme të vendit" (deklarata e Naim Hajrizit e datës 1 Mars 2010; dëshmitari ishte ballafaquar në këtë pikë, shiko procesverbalin e 5 Gushtit 2010, faqe 35).

Dhe po ashtu e vlen të konstatohet që, pasi është ballafaquar, Hajrizi ka pranuar që Veseli po ashtu ka marrë pjesë nga vet fillimi në biseda lidhur me pjesëmarrjen e mundshme në këtë grup të njerëzve për pronësi të në Hotelin Onix (procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe

36) dhe ishte bile i pranishëm kur paratë janë dhënë (procesverbali i 5 Gushtit 2010, faqe 38).

Për më tepër përfshirja e Azem Veselit në ngjarje del qartë nga ajo që është deklaruar nga Bajram Mehmetaj, para policisë me 1 Mars 2010.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa i përket kësaj pjesëmarrjeje në aksionet e Hotel Onix, marrëveshja ka qenë në mes jush, Muhamet Demaj dhe Naim Hajrizit?

Bajram Mehmetaj: Po, meje, Muhamet Demajt dhe Naim Hajrizit.

Kryetari i Trupit Gjykses: Mirë, sepse me 01.03.2010 ju keni thënë: “Unë sa bashku me shokët e mi: Muhamet Demaj dhe Azem Veseli kemi pasur një marrëveshje me Ekrem Llukën përmes një personi me emër Naim Hajrizi me të cilën marrëveshje pas privatizimit të Hotelit Onix ai do të na paguante një shumë prej 150000 Euro siç ishte akorduar para privatizimit.” Këto janë fjalët e thëna para policisë. Pra siç duket marrëveshja ishte në mes jush, Muhamet Demajt dhe Azem Veselit në njërin anë dhe Ekrem Llukës dhe Naim Hajrizit në anën tjetër.

Bajram Mehmetaj: Jo, kjo nuk është e saktë. Polici hetues më ka pyetur se kush kishte aranzhuar këtë marrëveshje dhe unë i kam thënë që ishte Muhamet Demaj me Naim Hajrizin. Pyetja tjetër ishte nëse Ekrem Lluka kishte pasur ndonjë njohuri lidhur me këtë (duke iu referuar marrëveshjes) dhe unë i kam thënë ndoshta. Pse kështu, sepse Ekrem Lluka ishte aksionari kryesor.⁵⁹

Dhe në fund përfshirja e Azem Veselit duket gjithashtu nga tekst mesazhi dërguar atij nga Muhamet Demaj me 11 Nëntor 2009 (“E morëm”) për të cilën i pandehuri nuk mund të jepte ndonjë shpjegim. Është për t'u shënuar që 11 Nëntori ishte dita në të cilën ishte shpallur që Ekrem Lluka ishte fitues provizor i tenderit.

Pasi vlerësuam situatën faktike, në fund mund të bëhet vlerësimi juridik.

Siç është e ditur mirë, elementet e veprës penale të detyrimit janë siç vijojnë:

- përdorimi i forcës apo kërcënimimi i rëndë për ta detyruar personin tjetër që të veproj në dëm të pasurisë së vet;
- qëllimi për të sjellë dobi pasurore të kundërligjshme.

Në rastin aktual tanimë është demonstruar që kërcënime të rënda janë adresuar në drejtim të Llukës edhe drejtpërsëdrejti edhe përmes Naim Hajrizit.

Është e qartë që kërcënimet janë bërë që të detyrojnë Ekrem Llukën të pranoj Muhamet Demajn dhe shokët e tij si aksionar në Hotel Onyx. Dhe në mënyrë që të çlirohet nga prania e kërcënimimit të rrezikshëm nga njerëzit e lartpërmendur Lluka dhe Hajrizi kishin vendosur t'u japin atyre 150.000 Euro.

Me 28 Shkurt 2010, kërcënime të rënda janë bërë kundër Llukës, në mënyrë që të detyrojnë atë të paguaj edhe 75.000 Euro.

⁵⁹ Procesverbali i 25 Gushtit 2010, faqe 22.

Nuk është e qartë nëse ka pasur apo jo biseda në mes Llukës dhe Demajt sa i përket përqindjes së aksioneve në Hotel Onix, para se ky i dyti të shpallet fitues provizor. I pandehuri deklaron që ka pasur marrëveshje, ndërsa pala e dëmtuar nuk e ka përmendur këtë.

Në mungesë të copave të provave sa i përket ndonjë marrëveshje të lidhur në mes dy personave (gjithashtu duke pasur parasysh që një marrëveshje e tillë nuk është konfirmuar nga pala e dëmtuar) versioni i Demajt, i cili përbëhet thjeshtë nga pretendime të cilat nuk janë vërtetuar nga versionet e dëshmitarëve tjerë, duhet të hedhen si plotësisht të pasigurta.

Vlen të potencohet që edhe nëse të pandehurit kanë menduar që ka pasur një lloj marrëveshje me Llukën dhe e kanë kërcënuar këtë të fundit në mënyrë që të marrin atë çka mendonin që ishte e drejtë e tyre, vepra penale e kryer nga të pandehurit prapë do të ishte Detyrim dhe jo Shtrëngim.

Në fakt kundërligjshmëria e përfitimit material është pranishme çdo herë që kërkesa e kryesit nuk pranon ndonjë formë të mbrojtjes nga ligji. Prandaj çdo lloj i marrëveshjes jo formale e arritur me Llukën apo Hajrizin në bazë të traditave vendore nuk ka pasur vlerë të ndonjë mbrojtjeje nga ligji i parashikuar me statut dhe prandaj çdo kërkesë e bazuar në një lloj marrëveshje të tillë do të ishte e kundërligjshme.

Prandaj sa i përket episodit që ndodhë me 21 Nëntor 2009, të gjitha elementet e veprës penale të Detyrimit janë të pranishme që të dy edhe te *actus reus* edhe te *mens rea*.

Lidhur me episodin që ka ndodhë me 28 Shkurt 2010, vepra penale e kryer duhet të klasifikohet si Tentim Detyrimi: në të vërtetë sjellja e ndërmarrë përbën të gjitha elementet e veprës penale të Detyrimit, por jo të gjitha elementet janë përmbushur, pasi megjithatë kërcënimeve nuk u janë dhënë para kryesve të krimit. Dhe është e qartë që në mënyrë që të kryhet përfundimi i Detyrimit duhet të ketë një veprim nga viktima që përbën dëm të pasurisë së tij, veprim që qartë mungon sa i përket episodit të Shkurtit 2010.

Megjithatë prokurori ka cilësuar sjelljen e bërë nga të pandehurit si Detyrim i përfunduar për 150.000 Eurot, gjykimi i bërë lart shpie te përfundimi që cilësimi i drejtë i sjelljes të ndërmarrë nga kryesit e veprës duhet të jetë Detyrim i përfunduar për 75.000 Euro të kryer në Dhjetor 2009 dhe Tentim Detyrimi për 75.000 Euro të kryer në Shkurt 2010.

Në këtë pikë është e padiskutueshme që cilësimi i dhënë nga prokurori nuk është i detyrueshëm për gjykatësin, siç parashihet në Nenin 386 të KPPK. Kodi nuk specifikon nëse cilësimi apo jo i prokurorit është i detyrueshëm për gjykatësin kur ri-cilësimi do të ishte në dëm të pandehurit; prandaj, sipas parimit të interpretimit *ubi lex voluit, dixit, ubi noluit, tacuit* (kur ligji donte të rregullonte një çështje e bënte, kur nuk donte nuk e bënte), duhet të supozohet që gjykatësi është i lirë që të ri-cilësoj një vepër penale, edhe pse është në dëm të pandehurit.

Megjithatë në rastin konkret ri-cilësimi i bërë nga trupi gjykues është padyshim në favor të të pandehurit, pasi dënimi për vepër penale të Detyrimit për 150.000 Euro do të ishte

më i rëndë sesa dënimi unik i dhënë për vepra penale të Detyrimit dhe të Tentim Detyrimit.

Në fund është e pakontestueshme që Demaj dhe shokët e tij kanë vepruar si anëtarë të një grupit të definuar dhe të krijuar si duhet. Kjo është bërë e qartë nga përemri “Ne” i përdorur në fjalinë: “*Ne nuk dimë vetëm të thyejmë dritare*”: dhe pikërisht nga fjalët e përdorura nga Demaj gjatë marrjes në pyetje me 19 Mars 2010: “*Ne e kërcënuam Naimin por në emër të tjetërkujt*”.⁶⁰

Dhe rrethanat që Demaj nuk ishte duke vepruar i vetëm rezultojnë shumë qartë nga letrat e dorëzuara në emër të Llukës në AKP, ku gjithmonë i referohet “*Demaj dhe grupi i tij*”. Edhe një shenjë që sugjeron që të pandehurit ishin duke vepruar si grup është fakti që, siç është cekur më herët, të gjithë të pandehurit kanë marrë pjesë në të shumtën e takimeve të mbajtur me Hajrizin (edhe kur janë bërë kërcënimet me 28 Shkurt 2010 dhe po ashtu kur janë dhënë paratë).

Për më tepër Hajrizi gjithashtu në deklaratën e tij dhënë policisë me 1 Mars 2010 flet qartë lidhur me grupin e njerëzve të përbërë nga të tre të pandehurit: “*Unë kam qenë i angazhuar nga fillimi në biseda që ishin bërë nga Ekrem Lluka dhe një grup i njerëzve të përbërë nga Muhamet Demaj, Bajram Mehmetaj dhe Azem Veseli. Fillimisht këta njerëz kërkonin 10% të vlerës së përgjithshme të vendit. Por pas shumë negociatave, frikësimeve dhe shantazheve të bëra në adresë të Ekrem Llukës, ne kemi arritur që t'u ofrojmë këtyre njerëzve shumën e 150,000 Euro e cila po ashtu ishte pranuar nga ta*”.

Sa i përket sjelljes së palës së dëmtuar/dëshmitarit Ekrem Llukës dhe dëshmitarit Naim Hajrizit, procesverbali i dëshmimit së bashku me deklaratat e dhëna gjatë hetimeve dhe aktgjykimi i tanishëm do të dërgohen në zyrën e Prokurorisë Komonale në Pejë, pasi të dy kanë kryer vepër penale të Deklarimit të Rrejshëm, në kundërshtim me Nenin 307 të KPK. Në të vërtetë të dy kanë gënjyer para Gjykatës si për origjinën e parave që i janë dhënë të pandehurve (paratë kanë qenë të Llukës dhe jo të Hajrizit) dhe po ashtu edhe për sjelljen e të pandehurve (posaçërisht gjatë hetimeve Hajrizi ka folur lidhur me shantazhin dhe frikësimin e bërë nga të pandehurit, por para Gjykatës ai ka mohuar të ketë thënë fjalë të tilla).

F. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

Kur gjykata të vendos dënimin penal ata duhet të kenë parasysh të dy, edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit - që është shtypja e aktiviteteve shoqërore të rrezikshme duke penguar të tjerët për të kryer veprime të ngjashme kriminale – dhe qëllimin specifik, të parandaloj të pandehurin nga përsëritja e veprës.

Në rastin aktual Trupi Gjykues ka ardhur deri te përfundimi që dy akte penale janë kryer kundër viktimeve. Sa i përket rrethanave rënduese, duhet të konstatohet që të gjithë të pandehurit vazhdimisht kanë gënjyer para gjykatës duke mohuar rrethanat e qarta. Edhe një rrethanë rënduese është që duhet të merret parasysh që paratë kurrë nuk iu janë kthyer Llukës dhe Hajrizit.

⁶⁰ Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të datës 25.08.2010 faqet 14-15.

Sa i përket rrethanave lehtësuese, duhet të merret parasysh fakti që të pandehurit nuk kanë pasur ndonjë dënim të mëparshëm.

Dënimi, duke marrë parasysh të dy rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese, do të jetë siç vijon:

dy (2) vite burgim për secilin të pandehur, lidhur me veprën penale të Detyrimit në bashkëkryerje , në kundërshtim me Nenin 23 dhe 267 par. 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK);

një (1) vit burgim për secilin të pandehur për vepër penale të Tentim Detyrimit në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 20,23 dhe 267 par.1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

Dënimi unik, sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe (2) Nënparagrafi “, të KPK, përcaktohet në (2) vite dhe gjashtë (6) muaj burgim për secilin të pandehur.

Koha e kaluar në paraburgim nga të pandehurit do të kreditohet kundër dënimin, sipas Nenit 391 Paragrafi (1), Nënparagrafi 5, Neni 531, Par. 4 dhe Neni 278 Par. 7 të KPPK.

G. SHPENZIMET

Pasi të pandehurit janë shpallur fajtor, ata duhet të kompensojnë shpenzimet e procedurës penale përveç përkthimit (KPPK, Neni 102, Paragrafi 1). Një aktvendim i posaçëm lidhur me shumën e kompensimit do të merret nga gjykata kur të merren të dhënat e tilla.

H. KËRKESA PRONËSORE JURIDIKE

Në fillim të shqyrtimit kryesor palët e dëmtuara janë përkujtuar lidhur me mundësinë që të ushtrojnë parashtrësë për të realizuar kërkesë pronësore juridike brenda procedurës penale, sipas Nenit 355, Par. 2 KPPK, por ai ka deklaruar që nuk e ka ndërmend të ushtroj kërkesë pronësore juridike. Prandaj gjykata nuk ka pasur nevojë të bëj vendim të posaçëm lidhur me këtë çështje.

KËSHILLA JURIDIKE

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut në Pejë, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data kur bëhet dorëzimi i kopjes së aktgjykimit.

Procesmbajtësja

Robina Struthers



Kryetari i Trupit Gjykses

Gianfranco Gallo